

URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE
BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE
NR.132 QERSHOR 2019



Tradita bektashiane
mrekullon Parisin

REDAKSIA:

KRYEREDAKTOR
Syrja Xhelaj

REDAKTORË
Nuri Çuni
Kujtim Boriçi

KORRESPONDENTËT
Jakup Gjoca - Greqi
Eugen Shehu - Zvicër
Përparim Kapllani - Kanada
Agim Cani - Gjermani
Enea Muhameti - Itali

KONSULENTË
Arian Leka
Zenel Anxhaku
Blerina Harizaj
Agim Zeka
Besnik Anxhaku

DESIGN
Studiograf "A&N"

SHTYPET NË
SHTYPESHKRONJËN

"Urtësia
Bektashiane"
Qershor, 2019



URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE
BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE
NR.132 QERSHOR 2019

Tradita bektashiane
mrekullon Parisin

Misioni bektashian



MISIONI BEKTASHIAN: VELLAZERIA FETARE!

Kryegjyshi Bektashian, Hishia e Të, Hishia Dede Edmond Bektashi, përcjellim Konferencën Botërore të Paqes në Berlin...

Duke pasur në sfond ngjarjet më të fundit në rrafshin fetar, por duke u përpjekur të gjejë rrugëzgjdhje për situata të ndryshme, Konferenca e Paqes Botërore, zhvilloi në Berlin në datat 14-15 qershor 2019, hodhi dritë në përpjekjet e vazhdueshme të religjioneve për të konverguar në harmoni dhe bashkëpunim.



Përrurohet sheshi "Dede Reshat Bardhi"

Sheshi Dede Reshat Bardhi që shpesh qëzohet me një grup të vogël të besimtarëve, tashmë është i hapur për të gjithë besimtarët dhe qytetarët...



Ditë në Alipostivan

Kam qenë vetëm 6-7 vjeçe kur me prindërit e mi, mora së pari rrugën për në teqenë bektashiane, në Alipostivan, në Përmetin e zemrave të çelura nga dashuria e Zotit.



DERË E ÇELUR PËR ÇDO BESIMTAR

Derë e çelur për çdo besimtar, një hapësirë e re për bashkëpunim dhe harmoni të gjithëve...



Traditë që na mrekullon të gjithëve

Për të katërtin vit radhazi tradita në metropolin botëror të kulturës, frymën e saj mistike, kujtimet e kodeve zakonore të saj, si edhe lirizmin e thellë të tingujve. "La Palace" i hapi sërish dyert në Paris...

Përrurohet sheshi "Dede Reshat Bardhi"

Tashmë, sheshi i madh i qytezës tek ish-Poligrafiku, në kufijtë administrativ të Selisë së Shenjtë Bektashiane në Tiranë, merr emrin "Sheshi Dede Reshat Bardhi", emrin e klerikut të njohur, i cili ka meritën kryesore e të padiskutueshme të ringritjes së objekteve bektashiane pas ndryshimeve politike të vitit 1990 në Shqipëri.

Ditë në Alipostivan

Kam qenë vetëm 6-7 vjeçe kur me prindërit e mi, mora së pari rrugën për në teqenë bektashiane, në Alipostivan, në Përmetin e zemrave të çelura nga dashuria e Zotit.


Derë e çelur për çdo besimtar

Çelja e teqesë së parë bektashiane në SHBA në majin e vitit 1954 këto dit në Detroit qindra besimtarë bektashianë në përkujtim të datës së shënuar. Me një ndjenjë të ligjshme krenarie, ata iu drejtuan tyrbes ku prehen baba Rexhebi dhe baba Arshiu...

Traditë që na mrekullon të gjithëve

Për të katërtin vit radhazi tradita në metropolin botëror të kulturës, frymën e saj mistike, kujtimet e kodeve zakonore të saj, si edhe lirizmin e thellë të tingujve. "La Palace" i hapi sërish dyert në Paris...

Përrurohet sheshi "Dede Reshat Bardhi"



Haxhi Dede Edmond Brahimaj: Ky shesh që merr emrin e myrshidit tim, dede Reshat Bardhit, kjo pemë që unë mbjell sot këtu, kjo pllakatë që zbulojmë së bashku, janë mirënjohje për kontributin e këtij kleriku, për punën që ai ka bërë në kohët e vështira të regjimit monist, e sidomos në vitet e para pas ndryshimeve të 1990-tës, kur u desh që të riorganizoheshin strukturat e besimit tonë, kur duhej të ringriheshin tyrbetë e teqetë e rrënuara, kur kushtet ishin tejte të vështira. Falënderoj me këtë rast dhe Jetmir Bodinin për realizimin e këtij projekti, bashkë me shokë e dashamirës që pati në krah, duke u kujtuar se Zoti i Lartë shikon e mbështet gjithkënd e gjithçka që bën punë të mira!"

Nga Kujtim BORIÇI

Tashmë, sheshi i madh i qytezës tek ish-Poli-grafiku, në kufijtë administrativ të Selisë së Shenjtë Bektashiane në Tiranë, merr emrin "Sheshi Dede Reshat Bardhi", emrin e klerikut të njohur, i cili ka meritën kryesore e të padiskutueshme të ringritjes së objekteve bektashiane pas ndryshimeve politike të vitit 1990 në Shqipëri. Tashmë, qindra e mijëra njerëz që punojnë e jetojnë në këto hapësira,

në godina administrative, biznese apo njësi shërbimi social (spitale, lokale), do i thonë njeri tjetrit: "Takohemi tek sheshi 'Dede Reshat Bardhi'", "Të pres tek sheshi 'Dede Reshat Bardhi'", "Eja të shikojmë sheshin, lulishten dhe bukurinë e 'Dede Reshatit'.... Ndërkohë, që kësaj qyteze të bukur e të mrekullueshme, i shtohet dhe një mjedis tjetër i gjelbëruar e mbi të gjitha, një memorial adhurimi e vlerësimi për klerikun që ishte dhe do të mbetet një burim drite, paqeje e shprese për miliona besimtarë bektashinj në gjithë botën... Por më tepër se sa një investim në kohë e në vlerë,

zbukurimi i kësaj qyteze të mrekullueshme, vendosja e pllakatës së mermertë me emrin e dede Reshatit, dita e përrimit, ishte një befasi dhe surprizë tejet e këndshme edhe për Kryegjyshin Botëror Bektashian, Hirësinë e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj: Gjithçka u finalizua në një ditë të veçantë, në ditën e 60 vjetorit të dede Edmond Brahimajt, ditë në të cilën ai u ftua, mbollti një pemë (ulli) në lulishten dhe preu shiritin e përrimit të sheshit, nën përkujdesjen e drejtorit administrativ të Kryegjyshit Botëror Bektashiane, Jetmir Bodini! Në fakt, Dede Edmond

Brahimajt, i ishte mbajtur 'sekret' një nismë dhe një investim i tillë, deri në momentin kur u ftua dhe u përball me sheshin e mbushur plot e përplot me njerëz dhe u ftua të mbillte pemën dhe të priste shiritin e përrimit të sheshit. Ndoshta, dhe për këtë fakt, fjalët e dede Edmond Brahimajt në këtë rast, që dilnin natyrshëm nga zemra, ishin ndër më të bukurat, ndër më të mirat, vlerësuese, mirënjohëse, plot mirësi dhe shpresëdhënëse për forcimin e dashurisë mes njeri-tjetrit dhe besimit në Zot... "Jam i befasuara dhe tejet i lumtur për gjithçka që është bërë... Nuk di çfarë të them, por

Zoti sjellë e bën gjithçka, kur besimi e shpresa tek Ai është misioni i jetës sonë. Ky shesh që merr emrin e myrshidit tim, dede Reshat Bardhit, kjo pemë që unë mbjell sot këtu, kjo pllakatë që zbulojmë së bashku, janë mirënjohje për kontributin e këtij kleriku, për punën që ai ka bërë në kohët e vështira të regjimit monist, e sidomos në vitet e para pas ndryshimeve të 1990-tës, kur u desh që të riorganizoheshin strukturat e besimit tonë, kur duhej të ringriheshin tyrbetë e teqetë e rrënuara, kur kushtet ishin tejet të vështira. Por besimi tek i Madhi Zot, me bekimin e Tij, me drejtimin e dede Reshatit, me mbështetjen e besimtarëve shqiptarë e miliona të tjerëve nëpër botë, u bë realitet ajo që në fillim, për shumëkënd, ishte ëndërr. Vëllezër e motra të pranishëm sot këtu. Edhe në këto momente, ne e kemi dede Reshatin këtu, ai na sheh, na bekon, na uron, na jep dritë e shpresë që të bëjmë së bashku më shumë në të ardhmen. Por për mua, si Kryegjysh Botëror, zgjedhja pikërisht e kësaj dite, ditëlindjes sime, për këtë veveniment tejet të rëndësishëm, ka domethënie e vlera të shumta. Faleminderit për vlerësimin që shprehni kështu për mua, por faleminderit dhe për mbështetjen që më jepni për të ardhmen, për punët e shumta që na presin të cilat do i bëjmë realitet me shpresën e mbështetjen e Krijuesit, për të bërë më shumë për forcimin e besimit tonë të shenjtë, shtimin e dashurisë për njeri-tjetrin, paqes, bashkëjetesës fetare, dashurisë për kombin...

Po në cilësitë e Kryegjyshit Botëror Bektashian, falënderoj me këtë rast dhe Jetmir Bodinin për realizimin e këtij projekti, bashkë me shokë e dashamirës që pati në krah, duke u kujtuar se Zoti i Lartë shikon e mbështet gjithkënd e gjithçka që bën punë të mira. Edhe një herë ju faleminderit. Zoti ju bekoftë ju e familjet tuaja; të gjithë paçi mbarësi në familjet tuaja!"

REALIZIMI I PROJEKTIT

Teksa dhjetëra punëtorë, prej disa ditësh po punonin për ndërtimin e një lulishtje në qendër të qytezës tek ish-Poligrafiku, në një prej këtyre ditëve, Jetmir Bodini që ishte me 'ta, më thotë: -Do të vish të shkojmë diku në periferi të Tiranës për të parë diçka? E pyes për çfarë, por shton se do e

shikojmë atje. Kështu bëjmë. Bashkë me Pëllumb Qosen, për një çerek ore, gjendemi në të dalë të 'Kombinatit', tek një firmë e njohur mermeri. Aty mësojmë e diskutojmë për zgjedhjen e mermerit për pllakën dhe bazamentin që do të vendoset në sheshin që do merrte emrin "Sheshi Dede Reshat Bardhi". Pra, projekti kishte kohë që kishte filluar, me hapjen e sheshit, punimet në 'të, gjelbërimin, zgjedhja e mbjellja e luleve, drurëve zbukurues etj... Kjo rrugë u bë disa herë, deri në ditën e përrurimit në sheshit më 19 maj 2019... Jetmiri na tha dhe për surprizën, përrurimin e sheshit në ditën që Kryegjyshi Botëror Bektashian, mbush 60 vitet. "U përpoqëm të bëjmë diçka që mendojmë se ja vlen"- pohon Jetmiri.

SHESHI QË TËRHEQ BESIMTARËT

Sheshi "Dede Reshat Bardhi" mirëmbahet çdo ditë si një nga objektet më të rëndësishme të qytezës. 'Qilimit' të madh me lule shumëngjyrëshe, çdo ditë i shtohen buqeta të tjera me lule që besimtarë e dashamirës vendosin tek pllakata e mermertë... Por mbillen dhe pemë dekorative në këtë objekt. E gjithë kjo përkujdesje dhe adhurim, ia shtojnë më tej bukurinë.

Dhe ky rit, bëhet nga njerëz të të gjitha moshave e profesioneve... Para pak ditësh, rastësisht, tek kalonim pranë sheshit "Dede Reshat", po shikonim një njeri që po mbillte një bli. Ishte mjeku i njohur, Pr. Dr. Krenar Preza. Takohemi me 'të, pasi mbolli blirin, duke ja lënë radhën punëtorit që të bënte sistemimin e plotë të saj në atë lulishte-minipyll. "Është një mjedis i mrekullueshëm, por që vlerat më të mëdha ja shton emri i dede Reshatit. E kam njohur nga afër këtë njeri të madh, këtë klerik të mrekullueshëm. Mësova për përrurimin e sheshit dhe fjalët e Kryegjyshit Botëror Bektashian, Haxhi Dede Edmond Brahimaj në këtë event, e mendova të mbjellë një bli. Respekte për jetën dhe veprën e ndritur të dede Reshat Bardhit, respekt për Kryegjyshin dede Mondin, respekt për bektashinjtë e besimin bektashian, këtë besim të paqtë, plot dritë, besim që predikon e praktikon të mirën, paqen, lirinë, dashurinë e harmoninë"- pohon Prof. Preza.

... Kjo pemë që unë mbjell sot këtu, kjo pllakatë që zbulojmë së bashku, janë mirënjohje për kontributin e këtij kleriku, për punën që ai ka bërë në kohët e vështira të regjimit monist,Por besimi tek i Madhi Zot, me bekimin e Tij, me drejtimin e dede Reshatit, me mbështetjen e besimtarëve shqiptarë e miliona të tjerëve nëpër botë, u bë realitet.



Prof Dr. Krenar Preza "Është një mjedis i mrekullueshëm, por që vlerat më të mëdha ja shton emri i dede Reshatit. E kam njohur nga afër këtë njeri të madh, këtë klerik të mrekullueshëm. Mësova për përrurimin e sheshit dhe fjalët e Kryegjyshit Botëror Bektashian, Haxhi Dede Edmond Brahimaj në këtë event, e mendova të mbjellë një bli. Respekte për jetën dhe veprën e ndritur të dede Reshat Bardhit, respekt për Kryegjyshin dede Mondin, respekt për bektashinjtë e besimin bektashian, këtë besim të paqtë, plot dritë, besim që predikon e praktikon të mirën, paqen, lirinë, dashurinë e harmoninë"

Ditë në Alipostivan

Kam qenë vetëm 6 – 7 vjeçe kur me prindërit e mi, mora së pari rrugën për në teqenë bektashiane, në Alipostivan, në Përmetin e zemrave të çelura nga dashuria e Zotit.

Kam qenë në ato vite vetëm disa mure të vjetër të ish teqesë dhe shumë drurë dhe ferra. Prindër të mi, të cilët e dinin se si kish qenë dikur aty, u pikonte trishtimi i thellë në zemra. Për mua ishte diçka e ftohtë, pa ndonjë ndjekje të përcaktuara qartë. Thellë – thellë nuk mund të mendoja, bile as për bektashizmin sepse përveç lutjeve të gjyshërve të mi, nuk kisha patur mundësi tjetër të futesha në lulishten e këndshme. Por nuk do të mund të harroja kurrë, që nga

ajo ditë, fytyrën e qeshur dhe ballin e lartë të dervishit të teqesë, Hekuranit, i cili si djalë Përmeti, kur prindërit e mi u prezantuan se ishin nga Frashëri, i nderoi në mënyrë të veçantë dhe mua mu drejtua duke më thënë: “Je vajzë e zgjuar dhe në shkollë do marrësh vetëm dhjeta”. Në të vërtetë, kjo profeci e tij me ndoqi dhe gjatë gjithë kohës edhe sot në vitet universitare, unë vijon të kem marrëdhënie të shkëlqyera me dituritë. Nuk e di, po ndofta profecia e dervish Hekuranit, mund të më ketë dhënë atë lloj besimi që nuk e patën asnjëherë shokët apo shoqet e mija.

Flas për këtu e 16 vite të shkuara. Ne ndenjëm gjatë me dervish Hekuranin dhe ndonëse ishte ditë pelegrinazhi, njerëzit nuk ishin të shumtë. Por ishte e plotë dreka që shtroi dervishi duke shërbyer edhe vetë si zot shtëpie me muhabetë dhe këngë bektashiane. Nuk kishte urdhra e komanda por në teqe, besimtarët e dinë secili vendin e tyre dhe e merr fjalën kur t'i vijë radha, zakonisht sipas moshës, duke respektuar sidomos myhibët e teqesë. Dhe kur fliste dervishi, të gjithë dëgjonin.

Por ai fliste shumë pak, përmende Imam Aliun, Imam Hysejnin dhe më pas rrëfeu për dede Reshat Bardhin, myshidin e tij, i cili ndonëse jetonte e drejtonte në Tiranë, në Selinë e Shenjtë, ishte shpirtërisht me çdo dervish apo baba, në çdo faqe brenda dhe jashtë Shqipërisë. Pastaj muhabetin e ndiznin këngët bektashiane që sigurisht kuptimin ua mësova shumë vite më pas.

Tani pas gjashtëmbëdhjetë vitesh, duke ardhur në Alipostivan, në vendin e drurëve dhe ferrave të dikurshme, më duhet se jam në ëndërr. Atje kur dikur pata parë rrënoja gurësh, janë ngritur dy tyrbe njëra më e bukur nga tjetra dhe duke lënë këpucët tek dera, pres radhën e gjatë të pelegrinëve, për të bërë lutjet e mija pranë mezareve, kur heshtja e thellë të ngjall emocione të pazakonta.

Këta dervishë dhe baballarë që prehen këtu, kanë jetuar me shpirtin tek Zoti, me brought e përmetarëve, me dashurinë për librat dhe gjuhën shqipe, me atdhetarinë e vërtetë që u rridhte në deje tok me gjakun e dëlirë. Ata kanë mëkuar dje dhe vazhdojnë të mëkojnë deri në ditët e sotme, brezat e përmetarëve me dashurinë për kombin edhe në këto ditë të vështira që po kalojnë.



Tek njeriu, ka shkuar përmetari i madh Naimi, janë brenda edhe engjëlli edhe djalli. Në teqetë tona, në tyrbet tona, në konakët e muhabetit dhe të dashurisë bektashiane, kush ka hyrë e ka nxjerrë nga shpirti djallin dhe ka mundur të jetë plot dritë dhe shpresë në krahët e engjëllit të Zotit.

Pastaj unë futem në radhën e pelegrinëve që do të takojnë baba Hekuran Nikollarin. E kam ndjekur nga larg. Kam mësuar se ka marrë titullin baba nga dede Reshat Bardhi dhe jam ndjerë edhe unë krenarë që një djalë i heshtur nga Përmeti e meriton këtë titull fisnikërie. Unë dua t'i drejtoj kur kam

ardhur për të parën herë, por çuditërisht sot janë qindra pelegrinë që duan ta takojnë dhe unë mjaftohem vetëm duke i puthur dorën dhe duke i thënë se jam nga Frashëri. Por babai më çudit kur me atë vështrim e qeshur dhe ballin e lartë më pëshpërit: "Unë të mbaj mend. Të kam thënë se do mësoh shumë në shkollë. Prindërit më kanë thënë se je ndër më të mirat në universitet!"

Çfarë krenarie ndjej të përzier me çudi. Por tani, kam studiuar disa gjëra për bektashizmin dhe mu kujtua shprehja e dervishit 16 vite më parë që ndërsa më takonte, më tha: "Mëso në shkollë por mos harro t'i lutesh

Zotit për gjithçka. Mos i ndaj mësimet nga lutjet!" dhe prej rrëfimeve të shumtë të Abdullahut, të birit të Abazit më erdhën dhe u zgjuan në vetëdije fjalët që i pat thënë Profeti ynë: "O bir! Po të them disa fjalë që mos t'i harrosh asnjëherë. Duaje Allahun që edhe Ai të dojë ty dhe të të nderojë. Në çdo punë e fjalë, vër përpara pëlqimin e Tij, sepse kështu ecën me Allahun përpara.

Nëse të mungon diçka kërkoje vetëm tek Ai, sepse Allahu nuk kursehet. Nëse lutesh për ndihmë, drejtoju vetëm Atij se është i Vetmi që fal ndihmë dhe dashuri. Dhe dije mirë se edhe sikur mijëra njerëz të mblidhen

Mëso në shkollë por mos harro t'i lutesh Zotit për gjithçka. Mos i ndaj mësimet nga lutjet!" dhe prej rrëfimeve të shumtë të Abdullahut, të birit të Abazit më erdhën dhe u zgjuan në vetëdije fjalët që i pat thënë Profeti ynë: "O bir! Po të them disa fjalë që mos t'i harrosh asnjëherë. Duaje Allahun që edhe Ai të dojë ty dhe të të nderojë. Në çdo punë e fjalë, vër përpara pëlqimin e Tij, sepse kështu ecën me Allahun përpara. Nëse të mungon diçka kërkoje vetëm tek Ai, sepse Allahu nuk kursehet. Nëse lutesh për ndihmë, drejtoju vetëm Atij se është i Vetmi që fal ndihmë dhe dashuri.



e të përpiqen të ndihmojnë, ndihma e tyre do të jetë vetëm në atë masë që Allahu ka caktuar për ty. Por edhe nëse mblidhen mijëra të tjerë për të bërë keq, dije se do të bëjnë deri në atë masë që Allahu ka caktuar për ty..." Librat dhe lutjet kanë qenë e mbeten të pandashëm në udhëtimin tim në këtë botë.

Në mjedisin e mrekullueshëm festiv, ka edhe një lajm tjetër të mirë për të gjithë besimtarët bektashianë. Baba Hekuran Nikollari është vlerësuar për kontributin e tij në gjithë teqetë e trevës, me titullin e larë "Nderi i Përmetit" dhe për këtë ai merr edhe urimet e dervishëve dhe baballarëve të tjerë, të cilët nuk mungojnë në Alipostivan, në çdo 14 maj sepse kjo vëllazëria bektashiane.

Një gëzim shumëfishohet kur ndahet midis vëllezërve, sikundër një brengë ndahet e bëhet copa kur diskutohet midis klerikëve apo besimtarëve.

Kjo frymë vëllazërie e ardhur nga larg, nga mugëtirat e tetë shekujve më parë, është shkëndijë e vetëdijes së Haxhi Bektash Veliut, e cila jo vetëm që nuk u fik në ditët më të vështira të besimit, por erdhi duke u shndërruar në flakadan drite dhe mirëkuptimi për breza të tërë. Sa i përket Shqipërisë, ky flakadan ndriti përmes sakrificash sublime në shpirtat e klerikëve që i duan dhe respektojmë nga thellësitë tona shpirtërore.

Më ka rënë rasti të kaloj në rrugën automobilistike të Përmetit dhe natën e vonë. Por kur hedh vështrimin në lartësitë e teqesë së Alipostivanit, mezi mbushem me frymë. Konturet e natës më duket se i japin këtij vendi një kontrast befasues dhe fiton ndjesinë se po të ngjitesh aty, je në qiell. Aq bukur qëndron teqeja me ato ndërtime plot simetri dhe mrekulli të ngritura nga duart e arta të përmetarëve, nga urtësia dhe bujaria shpirtërore e baba Hekuranit.

Sa dervishë dhe baballarë kanë shërbyer në këtë teqe? Sigurisht me dhjetëra e dhjetëra. Fjalët e tyre, këngët e tyre, lutjet e tyre dhe kujtimet e tyre të përjetshme, enden netëve në ata mure të bardhë, në drurët e lashtë të lisave, në fletët e arrave.

Të gjitha këto, fletë e zgjohen prej hapave tanë, pelegrinëve të sotëm që pavarësisht mrekullisë së ngritur në këto 16 vite, duan të dinë historinë e religionit, gjurmët që hodhën dikur të parët tanë, në dialogun e përjetshëm me Zotin.

Tani, udhën e nisur prej këtyre baballarëve zemërbutë dhe atdhetarë e vijoi në mënyrën më fisnike të mundshme baba Hekuran Nikollari. Le t'i përulemi atij me ndjenjën e respektit dhe dashurisë së përvuajtur!

Anisa Frashëri
Alipostivan, 14 Maj 2019

DERË E ÇELUR PËR ÇDO BESIMTAR

**Kremtohet në SHBA 65-vjetori i çeljes së
teqesë së parë bektashiane në Detroit-Miçigan**

Çelja e teqesë së parë bektashiane në SHBA në majin e vitit 1954 këto ditë në Detroit qindra besimtarë bektashianë në përkujtim të datës së shënuar. Me një ndjenjë të ligjshme krenarie, ata iu drejtuan tyrbes ku prehen baba Rexhebi dhe baba Arshiu dhe me kurora lulesh të freskëta jetuan emocionet e takimeve të dikurshëm me këta klerikë, duke iu drejtuar paskëtaj mjediseve të teqesë, me bisedat dhe përhëndetjet e mallit. Përveç të ftuarve të shumtë, këta besimtarë, kanë pritur plot interes Kryegjyshin Botëror Bektashian, Hirësinë e Tij, Haxhi Dede

Edmond Brahimaj, i cili ka shuar kërshërinë e tyre për veprimtaritë më të fundme të Selisë së Shenjtë Bektashiane anekënd botës. Më tej, të pranishmit janë mbledhur në darkën zyrtare të rrethuar nga atmosfera e gjallë e kësaj feste.

Ka qenë moderatori i kësaj mbrëmjeje z. Novruz Nazarko i cili ka çelur ceremonialin duke u kujtuar të gjithëve së kjo ditë e bekuar ka lënë gjurmët e veta jo thjeshtë në memorien e besimtarëve bektashian, por të krejt shqiptarëve, të çdo feje dhe ideje. Ai ka lexuar më tej përhëndetjen e Presidentit të Shqipërisë, Shkëlqesisë së Tij, Ilir Meta, dërguar dervish Eliton Pashajit, në



të cilën, midis të tjerave thuhej: "...Dëshiroj t'ju përcjellë urimet e mia më të sinqerta me rastin e 65-vjetorit të themelimit të teqesë së parë Bektashiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Emri i kësaj teqeje dhe i themeluesit të saj, Baba Rexhebit, të këtij patrioti të madh, do të jenë dhe do të ndriçojnë gjithnjë e më shumë në altarin e shenjtë të panteonit të ndritur të kombit tonë. Urime dhe mirënjohje për këtë vatrë patriotike, kombëtare, për baba Rexhebin emërdritur të kombit tonë dhe për gjithë shqiptarët tanë në SHBA. ...Duke qenë i dashur dhe i

hapur për të gjithë shqiptarët pa dallim besimi mes tyre, Baba Rexhebi u mbrujt, u përkrah dhe u ndihmua me dashuri të veçantë vëllazërore, atdhetare, nga Peshkopi i Kishës Shqiptare, kleriku patriot Fan Stilian Noli. Noli i madh, themelimin e saj e quajti vatrë të zjarrtë atdhetare, që do të bashkonte myslimanë, katolikë, ortodoksë, gjithë shqiptarët pa dallim, me dritëz dashurie dhe do t'i çonte ata në udhë të mbarë, kombin tonë drejt lirisë, emancipimit dhe prosperitetit. Sot, kur mbushen 65 vjet nga hapja e saj, kjo teqe vazhdon të mbajë lart, flamurin e besimit kombëtar mes dashurisë së SHBA-së vendit mik të kahershëm të kombit tonë. Mirënjohje për SHBA-në, mikun e përjetshëm të kombit tonë!"

Më tej përhëndeti Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili pasi falënderoi organizatorët e takimit si dhe të pranishmit tha: "...Vij sot këtu, në teqenë e ndritur të baba Rexhebit, në cilësinë e Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve dhe ju sjellë urimet më ët mira të miliona bektashinj nga Shqipëria, Ballkani dhe gjithë bota. Allahu i Lartë e ndriçoftë këtë vend të bekuar si deri më sot, me dritën

e mëshirës dhe paqes! Allahu i Lartë dhëntë vetëm paqe e mirësi në familjet tuaja! Sot, në këtë mjedis kaq të mrekullueshëm nuk ka vend për histori. Koha që rrodhi në këto 65 vite, tregoi veç të tjerave se kjo shtëpi e Haxhi Bektash Veliut në këtë vend të bekuar siç është Amerika, është ngritur e mbahet fort me kontributin e të gjithëve ju. Sepse ju ishit që hodhët themelet, ju ishit që dhatë gjithçka që duhej, ju falët gjithçka. Dhe sigurisht ishit me fat. Allahu i Lartë ua shpërbleu, duke ju sjellë këtu baba Rexhebin, baba Brajramin, dervish Lutfiun, baba Arshiun dhe tani së fundmi, nxënësin shpirtëror të

dede Reshatit, dervish Elitonin. Këta klerikë të vyer e kanë merituar përkujdesjen tuaj në dekada, sikundër ju motra dhe vëllezër të mijë, keni merituar urtësinë dhe dashurinë e tyre. Misioni i teqesë së baba Rexhebit, i ka kapërcyer prej kohësh hapësirat e pamata të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Dhe më tepër se kushdo, këtë mision të shenjtë e kemi ndjerë ne, bektashinjtë e viseve shqiptare në Ballkan. Ju të gjithë e dini se menjëherë sapo morën pushtetin, komunistët e Tiranës bënë ç'ishte e mundur ta vinin Partinë e tyre mbi fenë, ta godisnin besimin në Zot, derisa më 1967, me nen të veçantë të kushtetutës së vendit, sanksionuan mbylljen totale të objekteve të kultit dhe rrënimin e tyre. Me anë të kësaj lëvizje ateiste të paparë dhe të pa ndodhur deri asaj kohe, në asnjë vend të botës, të pafetë menduan se do të mposhtnin krenarinë tonë shpirtërore, por nuk ja dolën dot. Fshehurazi, në ilegalitet të plotë, në Shqipërinë e atyre viteve të errësirës, ne besimtarët bektashianë, sikundër dhe ata të feve të tjera, festuan bajram e pashkë, mbajtën matem dhe shpërndanë ashuren, me bindjen e thellë tek dashuria e Zotit. Në këtë kontekst, ne bektashinjtë

patëm si mbështetje të shkëlqyer morale, pikërisht teqenë e baba Rexhebit, këtë dritë të pa fikur të Haxhi Bektash Veliut. Sado të larta dhe të pakapërcyeshme ishin barrierat e ish-sigurimit të shtetit të asaj kohe, lajmet e ardhura nga kjo teqe, jo vetëm na gëzonin, por edhe na mbanin të gjallë shpresat tona se një ditë do t'u riktheheshim teqeve, do t'i riktheheshim klerikëve tanë të urtë, do t'i riktheheshim besimit që mbanë të gjallë jetën njerëzore. Prandaj, le të jetë kjo përshëndetja ime sot, një falënderim i veçantë i krejt bektashinje në Mal të Zi, Kosovë, Maqedoninë Perëndimore, Shqipëri etj, për këtë vatrë të shenjtë, për këtë shtëpi të dritës së Zotit dhe të robit."

Një mesazh urimi kishte ardhur edhe nga Ambasadorja e Shqipërisë në SHBA, znj. Floreta Faber, ndërsa të

pranishmit ndoqën plot interes edhe përshëndetjen e Imamit të Qendrës Islame Shqiptare në Dtroid, efendi Shuajib Gërguri, Krye Meshtarit të Kishës Katolike Shqiptare 'Zoja Pajtore', Dom Ndue Gjergji, si dhe të profesoreshës amerikane Francisc Trix, një personalitet i shquar në hulumtimin e bektashizmit.


Me interes, ndërkaq, u përcoll në sallë edhe përshëndetja e dervishit të teqesë, Eliton Pasahaj, i cili tha midis të tjerave: "...Është pa dyshim fat dhe kënaqësi e veçantë për mua, t'ju uroj mirëseardhjen në jubileun e lavdishëm të 65 vjetorit të çeljes së teqesë së parë bektashiane në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe i lutem Zotit të Lartë t'ju sjellë paqe dhe begati në jetët tuaja dhe në familjet tuaja në këtë botë dhe në tjetrën!

Në një ditë si kjo, me këtë ngarkesë kaq historike, përfytyrimi ynë shkon në mënyrë të ndërgjegjshme 65 vite më parë, pikërisht atëherë kur një grusht besimtarësh bektashianë, të mbledhur rreth baba Rexhebi Beqirit, me vullnetin e Zotit dhe guximin ndaj sfidave, vunë gurët e parë të këtij themeli. Bashkë me këta themele të kulluar, hidhte rrënjë edhe rrapi madhështor i Islamit, i ushqyer në vite me hadithet e bekuar të Kuranit Qerim, me shembujt sintetizues të

jetës të Profetit Muhamed, paqja qoftë mbi 'Të, si edhe dashuria dhe urtësia emblematike që shpërndante Piri ynë, Haxhi Bektash Veliu.

Nuk duhet të harrojmë për asnjë çast të dashurit e mijë, se që ky rrap i besimit të rritej i shëndetshëm dhe të shtrinte fletët e tij të gjelbra në shpirtrat e mijëra besimtarëve, ai kërkonte pa dyshim frymën dhe përkujdesjen e veçantë të paraardhësve të mijë: Baba Rexhebi Beqiri, baba Bajrami, dervish Lytftiu dhe deri tek më i fundmi, por jo më i pa rëndësishmi, baba Arshi Bazai. Sigurisht, në këtë yllësi të klerikëve bektashianë, baba Rexhebi ka vendin e vet të merituar.

Sa herë që ne, klerikët apo myhibanët e dalë prej mejdanit të tij, i afrohem kësaj figure madhështore, aq herë parashohim një varg cilësish hyjnore të sendërtu-



ara në sjelljet dhe fjalët e tij, ku në mënyrë të veçantë etja për dije, urtësia dhe dashuria për dheun-mëmë e ngrenë atë shumë lart, për ta vendosur në rrafsh gati mitologjikë.

Ashtu sikundër Ai vetë-fliste, por edhe për të gjithë ne, të djeshmit dhe të sotmit e kësaj teqeje, është plotësisht e kuptueshme se ndërsa linte Shqipërinë në nëntorin e trishtuar të vitit 1944, duke çarë detet e tërbuar me një motovedetë, baba Rexhebi do të linte në ato brigje malli, një pjesë të dashurisë së tij. Por gjithsesi, ne jemi po aq të kujdesshëm për të kuptuar se ky dervish nacionalist, linte teqenë e famshme të Zallit dhe myrshidin e tij baba Selim Gjirokastrën, në emër të një dashurie tjetër, akoma më delikate dhe të përgjegjshme, që do të mundësonte vazhdimin e misionit fetar dhe atdhetar, duke mbajtur në të vërtetë të pa fikur qiririn prometeik të tarikatit bektashian, të cilin totalitarizmi skllavërues shqiptar kërkonte ta

..Sot pas 64 vitesh, ne jemi të lumtur që Zoti ynë e ka dëgjuar lutjen e baba Rexhebit dhe e ka shenjtëruar teqenë tonë në përmbushjen e misionit të saj hyjnorë. Dhe pikërisht ky akt shenjtërimi, më jep mua personalisht guximin t'u kumtoj sot, të gjithëve në këtë sallë, se do të eci i sigurt në gjurmët e paraardhësve të mijë, në shembullin frymëzues të tyre, duke vijuar të ruajmë dhe pasurojmë së bashku traditat më të vjera të bektashizmit. Jam me fat gjithashtu tu tregoj urimin e marrë këto ditë nga Presidenti Tramp. Është nder dhe krenari që ky tarikat 800 vjeçar i Islamit, drejtohet sot nga Selia e Shenjtë në Tiranë dhe kjo na ngarkon me përgjegjësi historike të mëdha."

shuante përmes dogmave ideologjike të kohës. Por brenda përfytyrimit tonë për këtë ditë të bekuar, lëvizin shpesh imazhet tërheqës të atyre burrave që rrethuan baba Rexhebin, jo thjeshtë me dashurinë e tyre, por dhe me mendjet, privacionet, ndihmën financiare, deri tek mbështetja intelektuale.

Grupi nismëtar për ngritjen e kësaj teqeje, i përbërë nga zotërinjtë: Gani Moshë, Jashar Petrusha, Beçe Banushi, Abaz Myrtezaj, Nevruz Selfo, Syrja Gorica, Dule Këlcyra, Muhamed Zogari, Qemal Roshanji, Qani Prespa, Haki Kozeli, Resul Shkëmbi, Selman Zagari, Xhafer Demiri dhe Zenel Poloska, do të mbetet padyshim një krenari legjitime për brezat e djeshëm, të sotëm dhe të nesërm..



..Sot pas 64 vitesh, ne jemi të lumtur që Zoti ynë e ka dëgjuar lutjen e baba Rexhebit dhe e ka shenjtëruar teqenë tonë në përmbushjen e misionit të saj hyjnorë. Dhe pikërisht ky akt shenjtërimi, më jep mua personalisht guximin t'u kumtoj sot, të gjithëve në këtë sallë, se do të eci i sigurt në gjurmët e paraardhësve të mijë, në shembullin frymëzues të tyre, duke vijuar të ruajmë dhe pasurojmë së bashku traditat më të vjera të bektashizmit. Jam me fat gjithashtu tu tregoj urimin e marrë këto ditë nga Presidenti Tramp. Është nder dhe krenari që ky tarikat 800 vjeçar i Islamit, drejtohet sot nga Selia e Shenjtë në Tiranë dhe kjo na ngarkon me përgjegjësi historike të mëdha."

Ceremoniali vijoi më tej me bisedat në tavolina, me recitime, këngë dhe kujtime të paharruara nga vepërmtaria e shquar fetare dhe atdhetare e kësaj vatre të besimit të palëkundur për Krijuesin.

**Koresp. "Urtësia"
Detroid-Miçigan, maj 2019**

Edicioni i katërt i ditës së kulturës bektashiane në Paris

Traditë që na mrekullon të gjithëve



Për të katërtin vit radhazi tradita e vyer bektashiane, ka përcjellë në metropolin botëror të kulturës, frymën e saj mistike, kujtimet e kodeve zakonore të saj, si edhe lirizmin e thellë të tingujve. "La Palace" i hapi sërish dyert në Paris, duke pritur bektashinjtë, në përpjekjen e tyre të bukur për të festuar ditëlindjen e Naim Frashërit me një himn për Shqipërinë, sikundër vetë poeti do të kish dashur. Këngët dhe vallet, recitimet nën ritmin e veglave baritore si edhe mesazhet e përcjella, suallën në sallë së bashku me emocionet e

papërsëritshme edhe imazhe të kthjellët të një kulture shekullore që mrekullisht i shkon realitetit. Për më tej, isoja labe me drithërimat e saj shpirtërore dhe fizike, shpalosi dritën e folkut unik bektashian, të sendërtuar në gjeografinë e pasur të këtij besimi.

Ka qenë Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili kumtoi midis të tjerave:

Të nderuar miq nga Franca, Turqia, Egjipti, Shqipëria, Kosova etj, që keni ardhur sot në këtë event tonin, për të ndarë së bashku emocionet e edicionit të katërt, të "Ditës së Kulturës Bektashiane"!

Kam kënaqësinë e veçantë para së gjithash, t'ju uroj në emër të Selisë së Shenjtë Bektashiane, muajin më të bekuar për krejt botën myslimane. Ramazani është një ftesë hyjnore drejt njohjes së përgjegjësive tona në raportin unik me Zotin, me familjen, me të afërmit, me vetë shoqërinë njerëzore. Veçanërisht në këtë muaj, të gjithë ne, kemi nevojë më shumë se kurrë të dialogojmë me Zotin dhe njerëzit në krah, t'u përgjigjemi kodeve zakonore të agjërimit me shpirt dhe me trup të kërkojmë falje dhe mëshirë për të përsosur devocionin tonë fetar. Lus Allahun e Lartë që duke na pranuar agjërimit, adhurimin dhe veprat e mira, ky muaj të na mbështjellë të gjithëve me mirësinë dhe begatinë e vet!

Lidhja e ditës së kulturës bektashiane me ditëlindjen e poetit tonë kombëtar Naim Frashëri, është mjaft domethënëse. Poezia e tij, në të cilën simbolika e qiririt zbulon të vërtetën e madhe të një jete të kaluar për t'u bërë dritë të tjerëve, nuk është vetëm një pikë loti. Më tepër se kaq, kjo simbolikë na kujton dervishët dhe ballarët bektashianë, të cilët nga Azia e Largët në Australi e Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shkrinë jetët e tyre për lartësimin e shpirtit njerëzorë, për t'i drejtuar këta të



sigurt në udhët e vështira plot peripeci të devocionit ndaj Krijuesit. Për më tej, vepra e Naimit tonë i fali bektashizmit shqiptar edhe ndjenjat më të kulluara që ushqyen identitetin kombëtar.

Kultura bektashiane, ndonëse zë fill me përhapjen e besimit dhe urtësisë së Haxhi Bektash Velikut, tetë shekuj më parë, erdhi duke u zhvilluar përmes konteksteve, shtresëzimeve të ndryshëm fetarë dhe socialë me prirjen e përjetshme për të zbuluar mozaikun e Islamit. Tarikatet në përgjithësi dhe bektashizmi në veçanti, falë mundësive shprehëse të mistikës, ndikuan në kulturalizmin e ndjekësve të tyre, jo thjeshtë për të fituar territore shpirtërore, por sidomos të ngjallin në esencë të besimit të tyre ndjenjat e spikatura të harmonisë fetare, të krijimit të familjes shpirtërore me të njëjtat kode si të familjes biologjike. Ne jemi krenarë që jemi sot këtu, për të shpalosur me anë të nefeseve, ritmeve, poezive apo polifonisë, vlerat më të vyera bektashiane pikërisht në Paris, në qendrën e përjetshme kulturore të Europës. Ne jemi ndërkaq të përgjegjshëm se kjo kulturë shekullore, jashtë kësaj salle, jashtë dimensioneve të eventeve të tillë, ka për qëllim jo vetëm vëllazërimin mes tonë, por edhe nismën për t'u bashkuar kundër çdo fanatizmi fetar, keqpërdorimi të besimit apo shfaqjeve makabër të terrorizmit. Të bashkuar në devocionin ndaj Krijuesit, ne do të mundemi t'ia dalim në çdo situatë.

Ju faleminderit edhe një herë të gjithëve që keni ardhur

sot në këtë ditë bektashiane të kulturës, faleminderit artistëve të shkëlqyer që na mbështesin dhe sinqerisht faleminderit vëllait tonë, z. Aziz Vardar, i cili në cilësitë e Ambasadorit Kulturor të Selisë së Shenjtë për Evropën, po mundëson prej katër vitesh një veprimtari të tillë.

Zoti ju bekoftë të gjithëve! Amin!

Një fjalë e ngrohtë përshëndetëse ka ardhur edhe nga Ministrija e Ekonomisë znj. Denaj e cila vlerësoi jo thjesht ditën e kulturës bektashiane, por krejt frymën e paqte dhe tolerante të këtij besimi, duke i rritur vlerat Shqipërisë sonë. Më tej, ishte ambasadori i Shqipërisë në Paris, z. Dritan Tola i cili tha: Jam shumë i lumtur dhe i nderuar sot që jam mes jush, në këtë edicion të katërt parizian të mbrëmjes së kulturës bektashiane, pas edicioneve të mëparshme aq të suksesshme dhe që e kanë bërë atë një ritual të pazëvendësueshëm. Përfitoj këtu për të falënderuar veçanërisht zotin Hazis Vardar, i cili ka mbështetur organizimin e këtij aktiviteti të madh. Dua të shpreh nderimin e veçantë këtu për këtë shqiptar të madh, i cili punon e jeton në Francë së bashku me vëllain e tij Halilin dhe të cilët të dy nuk kursejnë përpjekjet për të ndihmuar kauzën e Shqipërisë, gjë të cilën e bëjnë çdo ditë e për të cilën mund të dëshmoj edhe unë si të tjerët.

Kemi gjithashtu nderin e veçantë dhe kënaqësinë e madhe të kemi përsëri mes nesh Hirësinë e Tij, Kryetarin shpirtëror të Komunitetit Botëror Bektashian, Haxhi Baba Edond Brahimaj, këtë personalitet të madh fetar



dhe human gjithashtu, personalitet jo vetëm i komunitetit bektashian, por i tërë shqiptarëve dhe në mbarë botën.

Me fjalën dhe veprën e tij, Baba Mondi është dëshmi jo vetëm e udhëheqjes së tij të urtë në krye të këtij komuniteti në Shqipëri dhe në botë, por ai përfaqëson atë pasuri të madhe që është bashkekzistenca dhe harmonia ndërfaqetare në Shqipëri.

Baba Mondi është një aktor i rangut të parë, i cili përpiqet çdo ditë për ruajtjen e kësaj pasurie të madhe të Shqipërisë. Bashkekzistenca paqësore e feve në Shqipëri njihet si karakteristikë e çmuar e shqiptarëve kudo në botë. Më lejoni t'ju kujtoj se, edhe për këtë arsye, Papa Françesku zgjodhi Shqipërinë si vendin e parë në Evropë për të bërë vizitën e parë pas zgjedhjes së tij në krye të Vatikanit, duke i bërë kështu një nder Shqipërisë dhe në mënyrë të veçantë përpjekjeve të të gjithë shqiptarëve.

Por, pasuria që përfaqësojnë besimet e ndryshme të shqiptarëve mund të kërcënohet në çdo moment dhe ne duhet të mos kursejmë asnjë përpjekje për ta ruajtur, zhvilluar dhe përshtatur me realitetin e sotëm si edhe përballë kërcënimeve të terrorizmit dhe ndërhyrjeve të ndryshme, qofshin me natyrë fetare, politike, etj. Do t'ua lë radhën me dëshirë kolegëve dhe miqve këtu për të folur për aspektet e ndryshme të mbrëmjes së sotme, por dëshiroj edhe njëherë të falënderoj dhe përsëris të gjithë ata që kanë kontribuar në organizimin e këtij aktiviteti dhe artistët që marrin pjesë, që bëjnë të njohur këtë botë të kulturës bektashiane veçanërisht të pasur në vlera kulturore, artistike, filozofike, humaniste dhe spirituale, një kulturë të mishëruar thellësisht në figurën e Baba Mondit dhe e cila, gjithë duke u zhvilluar në një kontekst fetar, është në radhë të parë e mbi të gjitha pjesë e kulturës së madhe të popullit shqiptar.

Është thënë më parë e do të thuhet në të ardhmen, por dëshiroj të kujtoj e të përsëris këtu kontributin e jashtëzakonshëm të shqiptarëve të fesë dhe kulturës bektashiane dhe të përfaqësuesve të tyre të shquar, ndër të cilët edhe poeti kombëtar shqiptar dhe bektashian Naim Frashëri, ditëlindjen e të cilit përkujtojmë sot, në rilindjen kombëtare dhe patriotizmin shqiptar. Shumë faleminderit i dashur Baba Mondi, falënderime edhe miqve të Selisë së Shenjtë Botërore Bektashiane, si edhe një herë një falënderim i veçantë për mikun tonë, Hazis Vardarin.

Mbrëmje të bukur të gjithëve!

Panelin e përshëndetjeve e mbylli ambasadori i Shqipërisë në UNESCO z. Ferit Hoxha:

Të dashur miq!

Nuk mund të habitemi e madje aq më pak të zemërohemi me askënd që do të thoshte se tashmë bektashinjtë janë vendosur në Paris.

Mbrëmja e katërt radhazi për kulturën dhe kontributin universal të bektashinjve këtu në Paris, risjell mesazhe të mençurisë, mirëkuptimit dhe paqes mbi Shqipërinë dhe vlerat e saj.

Jam i kënaqur që jam këtu dhe i lumtur që mund të them këto fjalë, duke festuar kulturën bektashiane dhe poetin e shkrimtarin tonë Naim Frashëri, një nga atdhetarët më të shquar të lëvizjes kombëtare për një Shqipëri të pavarur nga Perandoria Osmane.

Gratë dhe burrat, popujt, shoqëritë, të gjithë së bashku, në udhëtimin e tyre drejt të ardhmes, kanë qenë vazhdimisht në kërkim të vlerave morale, përsosmërisë shpirtërore, pastërtisë morale, barazisë, dashurisë dhe respektit. Ata që kanë dashur Bektashizmin nuk do të ishin zhgënjyer.

Qysh në lindjen e tij, Bektashizmi rezulton një rrymë

veçanërisht e hapur dhe tolerante e Islamit, e mbushur me një modernizëm të madh. Ai ka mbetur kështu gjatë gjithë historisë. Idetë e barazisë dhe respektit, të transmetuara nga agimi i themelimit të vëllazërisë, kontribuuan në avancimin e ideve dhe lëvizjeve progresiste përgjatë historisë.

Bektashinjtë zgjodhën Shqipërinë për të themeluar Qendrën Botërore. Nuk është aspak një rastësi. Një vend shumëfetar, ku komunitetet fetare kanë jetuar në respekt dhe harmoni përgjatë shekujve, Shqipëria mbetet strehë paqeje dhe garanci respekti.

Të dashur miq,

Nuk mund të rri pa thënë disa fjalë për çështjet aktuale. Siç e kemi parë, partitë pro-evropiane, për fat të mirë, kanë arritur të përmbajnë shtysën euroskeptike për momentin. Por është e qartë se partitë klasike janë në rënie dhe

euroskeptikët janë rritur ndjeshëm.

Vetëm një dekadë më parë, me disa përjashtime, e djathta ekstreme nuk ishte shumë e pranishme, jo kërcënuese dhe një rrymë marginale. Sot është e kundërta: vetëm disa vende evropiane ende i shpëtojnë pranisë së këtij fenomeni. Pasiguria për të ardhmen, shqetësimet dhe frika të shumëfishta e paraqesin tashmë atë, të paktën në disa vende kyçe, si një alternativë. Kjo nuk mund të na lërë indiferentë. Ndërsa Shqipëria pret përmbushjen e aspiratave të saj legjitime gjatë 30 viteve të bashkëpunimit evropian, disa politikanë në Francë janë hapur ndaj ngadalësimit të zgjerimit të BE të Ballkanit Perëndimor.



– Asgjë nuk mund të jetë më e padrejtë, më e dëmshme, më e gabuar dhe më kundërproduktive sesa vënia në pikëpyetje e përkatësisë së Shqipërisë në Evropë.

Asgjë nuk mund të jetë më dëshpëruese për popullatën dhe sidomos për të rinjtë, sesa ideja e një Evrope që nuk i dëshiron ata. Asgjë nuk mund ta zëvendësojë këtë aspiratë, këtë projekt, këtë dëshirë, këtë dashuri për Evropën.

Pikërisht për këtë arsye duhet të bëjmë më shumë, të jemi më të pranishëm, të shpjegojmë më mirë se kush jemi. Kultura dhe trashëgimia janë një mjet komunikimi i rëndësishëm dhe i fuqishëm për një njohje më të mirë të Shqipërisë, shqiptarëve dhe vlerave tona humaniste dhe evropiane.

Dhe pikërisht për këtë, unë përgëzoj Qendrën Botërore të Bektashinjve, teatrin Palace dhe veçanërisht Hazis Vardarin, i cili, nëpërmjet ditëve të Kulturës Bektashiane në Paris, kontribuon në mbarëvajtjen e tyre.

Faleminderit dhe ju uroj një mbrëmje të këndshme.

Publiku i ngrohtë francez, duartrokiti paskëtaj lojën mahnitëse në piano të Genc Tukiçit si edhe këngët e interpretuara përmes një vokali të spikatur të Krisildo Gaçe. Poetja dhe

pianistja e njohur franceze Cambou, recitoi një etyd për dervishët bektashianë, ku lirika e thellë pleksej me meditim karakteristk në mjediset e mrekullueshëm të teqeve. Fjalët e qiririt të Naimit tonë, kumbuan aq bukur në gjuhën e Viktor Hygoit, përmes një narrative melankolike të aktores së njohur znj. Dervishi, që zotëroi skenën deri në detajin më të vogël shprehës. Edhe grupi i njohur si shpirti mistikës, i udhëhequr plot kompetencë nga Enris Qinami, solli jehonat e betejave të Qerbelasë, kur Imam Hyseni dhe shtatëdhjetë dëshmorë të tjerë, falnin jetën në emër të dëlirësisë hyjnore. Ndërsa momenti më shpërthyes ishte interpretimi i grupit polifonik "Fladi i Ehli-Bejt". Një harmoni sintetike zërash, të paraprirë nga freskia e nefeseve bektashiane, bënë që parisienët të duartrokisnin gjatë dhe t'i përcillnin këto minuta të mrekullueshme pothuajse në këmbë. Në mbyllje të kësaj mbrëmjeje, presidenti i shtëpisë sufi të Francës z. Abdel Bencuik u shpreh: Keni një traditë të mrekullueshme. Kjo na bën krenarë të gjithëve ne, pjesëtarë të denjë të familjes myslimane.

Syrja Xhelaj
Paris, 27 maj 2019


Cikli poetik: "Tablo e ç'ngyrosur...."

Nga Veri Talushllari

Kur ti je shumë larg

Qiellit i mungon pëllumbi,
Detit i mungon delfini,
Pyllit i mungon dreri,
Trupit i mungon shpirti,
Mua më mungon Ti.

Rrugë plot zhurmë të New Yorkut,
Shkreti,
Gjithandej shkreti.



Zogjtë mbi ligeni

Një copës qiell zbritën punëtorët,
Në mes dy majash e një dige,
Lodrojnë mbi të zogjtë pranverorë,
Dhe nuk kuptojnë, ulen a ngjiten.

Vetëm kur sqepi u merr ujë,
Kuptojnë se qiellin e kanë lart,
Por nuk kuptojnë të mjerët shumë,
Për këtë 'qiell' që i lag.

Me siguri po ta kuptoja,
Gjuhën e tyre, cicërimat,
Në këtë vjershë do transkriptoja,
Një simfoni me violina.

Tek nisen prap në fluturime,
Mbi fshatra, qytete e plazhe,
Nuk e ndërpresin simfoninë,
Sikur t'i çojnë qiellit mesazhe.

Në to ata kanë për t'i thënë,
Për këtë tokë të çuditshme,
Ku njerëzit copa të tij venë,
Midis dy majash e një dige.

Natë pas ndarjes

As në gjumë e as i zgjuar,
Gjoksi një det' i trazuar,
Një lot natën paska shpuar,
Pas ndarjes ditën e shkuar.

Dëshirë nëne...

Vjen një moshë e në derë kur hyjmë,
Nëna mu në bebëza na ngul sytë,
"U të keqen nëna, qenke vetëm!
Kur do t'hysh në derë vet' i dytë!?"

Tënden bir, e ke gjithë Shqipërinë,
Hidhi sytë ndër vajza, mos ki frikë.
Veç mendohu! Nusen unë ta dua,
Në mes shoqesh, lule edhe dritë!"

Tetor-dhjetor 1981

Pranvera

Pranvera nuk është stina e pas-dimrit
Pranvera është stina e blerimit.

Pranvera nuk është as marsi, as prilli,
Pranvera është zogu në degën e blirit.

Pranvera s'është deg' e mimozës nën rrezet e hënës,
Pranvera është buzëqeshja që bija i jep nënës.

Pranvera nuk është rrënjë, as degë e as trung,
Pranvera është fëshfërimë e gjetheve në muzg.

Pranvera nuk është bukuria mahnitëse në portret,
Pranvera është lot i piktorit kur bojërat i tret.

Pranvera nuk është vargu i poetit, as ritmi, as rime,
Pranvera është ajo që s'lexohet, psherëtima.

Pranvera nuk është syri, i zi qoftë, i kaltër,
Pranvera është vështrimi, si qiell i pastër.

Pranvera nuk është zgjimi i beftë prej ëndrrës,
Pranvera është rrahja, është rrahja e zemrës.

Borxhet

(Duke lexuar Xhevahir Spahiun)

E kush i shleu borxhet të gjitha,
Kush mund të mburret për këtë...,
Jo more mik! Borxh është dhe lindja,
Dhe vdekja borxh, që ç'ke me 'të.

Borxh i ke nënës qumështin e bardhë,
Dhe vajzës borxh, për gjijtë e ëmbël,
Borxh i ke Zotit që të mbanë gjallë,
Dhe baltës borxh që e shkel me këmbë.

Borxh i ke tokës- je tokësor,
Shqipërisë borxh- je shqiptar,
Ke borxh ndaj diellit që të ngroh,
Dhe ndaj dëborës që të zbardh.

I rëndë është borxhi, si hije,
E kur e shlyen, një mal shkarkon,
Po kush ja shleu borxhin Sadijes,
Që mbajti malin, Dritëronë....?

Eh borxhet, borxhet, ç'ti numërojmë...

Mësueses

(Sashenko Rinos)

Ti erdhe si qeshje mes nesh,
Si flladi në mbrëmje pranvere,
Siç dielli derdh rrezet mbi qieth,
Ti shpirtin të pastër e derdhe.

E lehtë si flutur mbi lule,
E thjeshtë si lulja mbi tokë,
E brishtë si këngë e një çule,
E ngrohtë si gjak në aortë.

E bukur, e bukur-ylber,
Plot ngjyra, plot jetë e gaz,
Rini, rini shpirti rrjedh,
Burim me ujë kristal.

Dhe vitet ikin, më s'vijne,
Ca plaken e ca mbeten vasha,
Por ti mos e lër rininë,
Të t'ikë nga shpirti moj Sasha!

Requem

E hënë është sot? Pardje kisha ditëlindjen.
Nuk di sa vjeç u bëra. Po gruaja thotë dyzetë.
Shoh veten në pasqyrë. Nuk kam filluar të thinjem
Kërkoj me gishta pulsing. Nuk rreh, pra s'jam më në jetë.

Njëzet e nëntë korrik? Pra qenka e vërtetë.
Pardje kisha ditëlindjen. Dhe mbusha dyzet vjet.
Po pse s'këndon gjinkalla? Bilbili ku do jetë?
Këndojnë e s'dëgjoj unë? Nuk ndjej, pra s'jam në jetë.

Pardje kisha ditëlindjen. Dje vajta pak në plazh.
Njerëzia duan Diellin. Është, thoshin, shumë nxehtë.
Pse mua s'më djeg vallë? As detin nuk e pashë.
Vërtet ishte aty? Nuk shoh, pra s'jam në jetë.

Qirinjtë ndezur mbi tortë. Oh ç'mrekullohet vajza!
Më puth, më përqafo. Kërcen e duartroket.
"Eja t'i shuajmë o babi! Shiko, janë dyzet fletëza!"
Por unë s'l shuaj dot. S'kam frymë, pra s'jam në jetë.

Meditim në teqenë e Kicokut...

Vështirë se Kicoku, ky breg i shenjtë ku shekuj më parë është ngritur teqeja bektashiane ka ditë më të kthjellëta se fund maji. Nëse sytë çlodhen në Trebeshinë dhe Nemerçkë, ata habiten në ato shpate të blertë të Tomorrit që të çojnë tek tyrbja emblematike e Abaz Aliut. Pastaj këto ndjesi kaq fatsjellëse bëhen njësh me lartësitë shpirtërore që lidhen me emrat dhe veprën e baballarëve dhe dervishëve të kësaj teqeje. Unë besoj se shpirti i ka sjellë sot, në këtë teqe, këta pelegrinë nga Tirana e Durrësi, nga Përmeti dhe Tepelena, të cilët ndonëse të lodhur nga rruga e largët dhe jashtë kujdesit shtetërore, lënë mënjanë brengat e kësaj bote, për t'u afruar në devocionin e

tyre ndaj Krijuesit. Për shumicën e tyre, për ata që kanë mbledhur disa lekë mënjanë vetëm për këtë ditë të bekuar, shkon më së miri thënia profetike: Dashuria profetike është nga besimi!

Me mua, për të festuar së bashku 20 majin, ditën e themelimit të teqesë, ka ardhur edhe Haki Cenolli. Shtatëdhjetë e ca vite mbi supe, nuk ja kanë larguar atij vështrimin e gjallë dhe humorin e shëndetshëm. Veçanërisht, pas kalimit nga kjo jetë të vëllait të tij, Aliut, i cili u kujdes për teqenë e Kicokut deri në frymëmarrjen e fundit të tij. Hakiu ka dëshirë dhe më rrëfen për 20 majin e viteve më parë, atëherë kur për të çelur themelet e tyrbes, kishte ardhur në këto maja dede Reshat Bardhi. Njerëzit ishin mbledhur poshtë

lisave dhe pasi e takuan, e pyetën për shëndetin. Dede Reshati, ishte menduar pak dhe pastaj u kishte thënë të gjithëve me atë çiltërsinë e vet karakteristike: "Bijtë e mijë! Edhe ne, klerikët, pavarësisht se na shihni këtu të qeshur dhe të fortë, kemi brengat tona. Kemi vuajtur shumë se pse ju e dini si na kanë spiunuar, rrahur dhe torturuar. Të gjitha ato vuajtje kanë lënë vraga në ndërgjegjen tonë. Po ne jemi të vendosur për të ecur në rrugën e Haxhi Bektash Veliut pa u dorëzuar. Ju me të vërtetë vini tek ne dhe merrni forcë e besim. Por edhe ne, nga ju mbahemi në këmbë. Si të mos qëndroj unë kur shoh sot që keni ardhur me qindra, pa ftesa, pa thirrje, pa detyrime. Keni ardhur të vendosim gurin e themelit të tyrbes, për të ngjallur bektashizmin, për të përjetësuar veprën e baballarëve tanë. Vetëm duke u mbajtur kështu tek njëri-tjetri, ne do të ecim duke u rritur në shpirt dhe në mendim."

Pranë tyrbes së mrekullueshme me pamje nga Abaz Aliu i Tomorrit, dervish Mikel Oneja, bashkëbisedon me një grup pelegrinësh. Biseda nis për mezarët, për historinë e lavdishme të klerikëve tanë dhe më tej, vijmë tek hallet e përditshme, tek ky realitet i trishtë, që më shumë se kushdo, e ndjejnë pikërisht këta përmetarë të fshatrave të largët, të cilët janë larguar dhe largohen dita-ditës, nga sytë këmbët, për një të ardhme të sigurt, për veten dhe për fëmijët.

Dervishi, sidoqoftë, më mendimin e tij të pjekur i fton ata pelegrinë të kenë më shumë besim edhe tek Zoti edhe tek Shqipëria, sepse në fund të fundit, vatani mbetet vatan edhe kur fati aty të qëllon me gurë. Në fjalën e tij, së bashku me urimet, ai përçjellë idenë se pikërisht në kohëra të tilla, klerikët bektashinj kanë bërë kurdoherë thirrje për urtësi, për tolerancë dhe paqe. Sepse nga meritë dhe

sherret me njeri-tjetrin ne e kemi paguar shtrenjtë.

Paskëtaj, në oborrin e teqesë, rrethuar nga mikpritja e pelegrinëve, dervish Mikeli përçjell urimet më të mira të Kryegjyshit Botëror Bektashian, Hirësis së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj për datën e shenjtë të 20 majit. Ai uron në veçanti Xhelo Cenollarin, i cili përpiqet të mbajë lart dhe të çojë më tej traditën bektashiane të mëkuar prej të parëve të vet. Një thirrje shkon këtë ditë edhe për nipër e mbesa të baba Sejdit nga Dukajt e Tepelenës, i cili duhet t'i rikthehet kësaj teqeje ku shërbeu për dy dekada me radhë. "Vendi i mezarit të tij-përfundon dervish Mikeli-është tek tyrbja këtu në Kicok. Nderi i dervishit dhe babait është në teqe."

Më tej, bisedat marrin udhë në tavolinën e muhabetit bektashian, ku hareja e disa çasteve mërgon hallet e pelegrinëve.

Syrja Xhelaj



MISIONI BEKTASHIAN: VËLLAZËRIA FETARE!

**Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij,
Haxhi Dede Edmond Brahimaj, përshëndet
Konferencën Botërore të Paqes në Berlin**



Duke pasur në sfond ngjarjet më të fundit në rrafshin fetar, por duke u përpjekur të gjejë rrugëzgjdhje për situata të ndryshme, Konferenca e Paqes Botërore, zhvilloi në Berlin në datat 14-15 qershor 2019, hodhi dritë në përpjekjet e vazhdueshme të religjioneve për të konverguar në harmoni dhe bashkëpunim. Me pjesëmarrjen e liderve të lartë fetarë

por edhe politikanë nga Arabia Saudite, Egjipti, Isaku, Siria, Algjeria, Pakistani, Zvicra, Gjermania, Holanda, Spanja, Danimarka, Irani, Suedia, Islanda, Anglia dhe Irlanda, Konferenca priti edhe delegacionin e Selisë së Shenjtë Bektashiane, të kryesuar nga Kryegjyshi Botëror Bektashian,

Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj.

Me fjalën, por dhe me përvojën e tyre, liderët fetarë

pjesëmarrës në këtë event, sollën një pamje të qartë të zhvillimeve të sotme në kuptimin e harmonisë fetare, duke evidentuar faktin se të gjithë kemi një Zot, Atij i falemi dhe Atij i atribuojmë gjithçka. Duke qenë përballë këtij realiteti të pashmangshëm ndër shekuj, prirjet e besimtarëve vlen të orientohen drejt mirëkuptimit dhe harmonisë si të vetmet kushte të ndërtimit të paqes.

Në ditën e parë të Konferencës, të pranishmit ndoqën me interes të veçantë përshëndetjen e Kryegjyshit Botëror, i cili tha midis të tjerave:

Të nderuar vëllezër të mijë, përfaqësues të lartë të feve, të pranishëm!

Të nderuar organizatorë të konferencës së paqes në Berlin!

Kur flasim për ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin jemi të ndjeshëm të gjithë, pasi në çdo fe dhe besim, qysh nga tradita e hershme e eshkuar në pergamenë dhe deri në ditët e sotme, Zoti ynë i vetëm, ka thirrur vetëm paqe e mirësi. Është një e vërtetë e pamohueshme se nga brezat e më shumë se një miliard myslimanëve aktualë, pëshpëritet me shpirt thënia "Selam alejkum", duke nënkuptuar paqen në të dy botët, në këtë të përkohshmen dhe tjetrën, të përjetshmen. Këtë paqe mrekullisht, një miliard e më tepër myslimanët nuk ja urojnë vetëm familjes dhe të afërmeve të tyre, por krejt botës në çdo vend ku ata jetojnë.

Esenca e filozofisë Islame është paqja, është nënshtrimi ndaj vullnetit hyjnor të Krijuesit, është rendja deri në fund të jetës fizike për të vënë në vend fjalët e Tij. Myslimanët janë emblema e mirësisë, ndaj dhe në Kuranin Qerim thuhet tekstualisht: "...Kush vret dikë, që nuk ka vuarë njeri apo nuk ka sjellë ç'rregullim në këtë botë, është sikur të ketë vuarë gjithë njerëzimin. Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetët e krejt njerëzve...". Një sintetizim i tillë



i marrëdhënies midis njerëzve dhe vetë shoqërisë njerëzore me Krijuesin është gati unik në të gjithë librat tanë të shenjtë.

Megjithatë, në të shumtën e rasteve, sidomos në këto dy-tri dekadat e fundit, terrorizmit ndërkom-bëtar i bashkëngjitet termi "islamik" dhe i shoqëruar me zhurmë mediatike gjithfarëlojesh, krijon ndjesinë se ky rrezik i paqes botërore vjen vetëm prej myslimanëve. Është disi e çuditshme, por faqet e gazetave, sidomos në Europë si dhe emisionet më të shikuar televizivë, marrin përsipër të "demaskojnë" doktrinën myslimane, pa kuptuar se në thelb të saj është



të mrekullueshme fetare dhe vijojmë sot të modlojmë të ardhmen, përmes asaj që Papa Françesku e nënvizoj në vizitën e tij në Shqipëri si "vëllazëri fetare". Ky status fetar aktual, nuk na ka bërë aspak indiferentë ndaj zhvillimeve dhe prirje të besimit, përkundrazi, plot vetëdije jemi rreshtuar përkrah forcave realisht progresive për ndërtimin e urave të paqes fetare si dhe denoncimin e çdo vandalizmi që gjoja vjen nga qiejt.

Më lejoni së fundmi, t'ju bëj me dije edhe rreth një hadithi kuranor, i cili

përcjell saktësisht: "Gjithçka e mirë që të vjen ty, o njeri, vjen prej Zotit të Lartë. Çdo e keqe që të godet, është prej vetes tënde!" (En-Nisa 79).

Prandaj le të bashkohemi së bashku kundër të keqes. Për brezat e sotëm dhe të nesërm. Për paqen universale. Zoti ju bekoftë të gjithëve!
Amin!

Në ditën tjetër të këtij eventi, Kryegjyshi Botëror Bektashian, pati rastin të takohet dhe të bisedoj me lider të shumtë fetar nga Iraku, Siria, Egjipti, Arabia Saudite, Gjermania etj, me të cilët u shkëmbye përvoja e kontributeve dhe përpjekjeve për arritjen e paqes dhe në ato zona, të konsideruara "të nxehta". Mjaft domethënëse ishte gjithashtu edhe biseda me Shenjtërinë e Tij, Ajetullah Hysejn Sadr, i cili pasi vlerësoi kontributin e tarikatis bektashian brenda familjes së madhe të Islamit, theksoi edhe përpjekjet e sotme të Selisë së Shenjtë Bektashiane, veçanërisht për frymën e paqes të shpërndarë në Ballkan. Nga ana e tij, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, pasi falënderoi mikun e lartë për konsideratat u shpreh midis të tjerave se misioni bektashian ka qenë dhe mbetet në shekuj: vëllazëria fetare! Këtë përgjegjësi askurrë nuk do ta heqim nga supet tanë, përfundoi ai.

Konferenca në fjalë dha mesazhe të pastra të kontributeve fetare në vazhdimësi.

Koresp. "Urtësia"

mëshira hyjnore universale. Siç është gjithashtu e çuditshme që ngjarje të tilla si masakrat e serbëve në Bosnje ndaj myslimanëve të pafajshëm, apo ato të Moskës ndaj myslimanëve çeçenë, të fëmijëve në Palestinë, të genocidit ndaj shqiptarëve të Kosovës e plot realitete të tjerë të dhimbshëm, lihen në periferi të memories njerëzore.

Në këtë kontekst, unë do t'ju kujtoja sot të pranishmëve këtu se terrorizmi nuk ka as fe, as atdhe, as ngjyrë dhe as etni. I organizuar apo jo i tillë, i ardhur prej myslimanëve, të krishterëve apo budistëve, terrorizmi përfshin një varg fenomenesh njerëzore, diktatorialë, ekonomikë dhe kulturor, të cilët vlen së pari të njihen qysh në lindje të tyre dhe mandej të analizohen në dritën e zhvillimeve të sotme. Jo domosdoshmërisht termi i frikshëm "fondamentalizëm" lidhet me Islamit e sotëm, përkundrazi, kjo përpjekje duhet parë se vjen prej atyre që nuk njohin në të vërtetë thelbin e Islamit. Një analizë më e thelluar e strukturave të shoqërisë njerëzore, studimet e formacioneve moralo-kulturorë si edhe traditave fetare myslimane, mund të na ndihmojnë të perceptojmë realisht rreziqet e sotme të terrorizmit.

Të nderuar të pranishëm!


Kombit të cilit i përkas etnikisht, Shqipëria, ka qenë dhe mbetet i ndjeshëm kundrejt çdo lloj ekstremizmi të dhunshëm apo akti terrorist. Ne kemi trashëguar prej të parëve tanë shpirtërorë një bashkekzistencë

Besimi si margaritar...

Vështirë të kuptosh se nga vjen kjo dritë, këtu në tyrben e baba Aliut, në Bubësin e Përmetit ku trëndafilat e mbjellë nga dora njerëzore, njehsohen jo rrallë me ata të mbjellë në kopshtet e shpirtit. Dielli i qershorit është rrekur të fshijë gjurmët e vesës, por në trëndafilishten përqark tyrbes dhjetëra e dhjetëra pelegrinë në biseda të gëzuara me njeri-tjetrin, sjellin ndërmend urtësitë e baba Aliut, të cilat shoqëruan jetët e tyre në pikëllimet e thella dhe në gëzimet e përkohshëm. Në këto biseda, ajo që bën më shumë përshtypje është ideja e Krijuesit të Gjithëmëshirshëm. Se vetë besimtarët e pranojnë se të parët e tyre, vetë këta, por dhe motrat apo vëllezërit e tyre kanë bërë gabime në këtë jetë të përkohshme. Por kur zemra është e mbushur me çiltërsi dhe devocion, ajo kërkon falje. Për këdo që njih məkatin dhe mërgohet prej tij, duke u kthyer tek Krijuesi me një kthim të sinqertë, dera e mëshirës qëndron hapur, dritaret e orientimit përcjellin dritë. I fundmi poeti ynë, Mehmet Akif, përpara disa dekadave, në lidhje me trëndafilishten e mrekullueshme të besimit do të linte dy vargje të pakrahasueshëm në botën e nefeseve:

*Besimi është margaritar,
Sa i madh është, o Zot!
Zemra e mjerë pa besim,
Është vetëm barrë në gjoks!*

Vetëm një marrëdhënie unike midis besimtarëve dhe baballarëve, ka mundur të mbajë gjallë tarikatin bektashian në kohërat më të vështira të tij. Vetëm një dashuri e tillë, e thellë, e heshtur, e ka shndërruar vëllazërinë bektashiane në mite që i takojnë ende sot, qoftë edhe në lartësi të tilla gjeografike



... Nuk mungon me urimin e saj edhe nënë Sanija e cila e mbyll përshëndetjen me fjalët: "Marshim nga drita e baba Aliut dhe dede Reshat Bardhit! Ky çirak në Bubs, mos u fiktë në shpirtat tanë! Kështu ju do nëna të gjithëve, të mbledhur së bashku, në sofrën e dashurisë të Haxhi Bektash Veliut dhe me këngë në buzë!" ...

ku mendimet i ndan me njerëzit dhe majat e maleve. E vërteta e tyrbes së famshme të baba Aliut ka udhëtuar përmes tri stacioneve të dhimbshëm por edhe domethënës në kontekstin e lidhjes myrshid-myrid. Së pari, ditët që ajo u ndërta nga baballarët dhe besimtarët përmetar që në kujtim të veprës së vyer të baba Aliut. Mekame të tillë ishin si prushi. Ata mbanin gjallë atë frymë tradite, atë trëndafilshite besimi të mbjellë me aq durim nga Haxhi Bektash Veliu. Së dyti, gjëma e jugut të Shqipërisë në vitet 1912-1914, nuk do të kalonte pa u ndjerë edhe në bektashizëm. Andartët grekë, pas mizorive me klerin bektashian, u vunë zjarrin tyrbeve

dhe teqeve, duke dashur të fshijnë gjurmët e mrekullueshme të këtij besimi. Tregojnë pleqtë e Bubësit dhe Vokopolës se flakët e tymi i tyrbes së baba Aliut vazhduan për dymbëdhjetë ditë rresht, por ky vend i dashurisë së dliurë u ringrit në vitet 1916-1917 nga vetë besimtarët.

Edhe shtjellat e luftës italo-greke nuk ishin ët pakta këtyre anëve. Tyrbja do të rrënohej sërish, por në vitin 1945 ishin familja Zaimaj dhe disa myhib të Bubësit, që përmes varfërisë së madhe të asaj kohe, gurë-gurë do ta lartësonin tyrbenë në peizazhet e gëzuar të shpirttrave. Dy dekada më pas, tyrbeja do të rrënohej prej ateizmit

barbar. Kush ka njohur nga afër nënë Sanijen, kush ka dëgjuar rrëfimet e saj ngjethëse, nuk do të harroj kurrë se pavarësisht agresionit shpirtëror të segmenteve të caktuar të shtetit të diktaturës, besimtarët bektashianë vinin këtu fshehurazi, ndiznin qirinj, flisnin me baba Aliun, i luteshin gurëve të shembur të tyrbes, i luteshin Zotit të mos i linte gjatë në këtë errësi. Për të ardhur kësaj deri në fillim të viteve 2000, atëherë kur vëllezërit Zaimaj, dërguan në Kryegjyshatë Gencin, me misionin për të takuar dede Reshat Bardhin dhe për t'i rrëfyer 'hallin' e tyre.

Me Genc Zaimin shkuam tek dede Reshat Bardhi dhe ky dëgjo

në heshtje, dëshirën e vëllezërve për të ringritur tyrben, jo thjeshtë si objekt guri të latuar, por me idenë e çeljes aty të një teqeje, të festimit të një date të caktuar, të ringjalljes së vetë bektashizmit. Mbaj mend se si u çel fytyra e dedeit dhe duke e përqafuar fort Gencin, i tha: "Biri im!

Nuk ka gjë se të ngresh një tyrbe apo një teqe. Ju do të keni kurdoherë jo vetëm mbështetjen e Kryegjyshatës, por dhe ndihmën e Zotit dhe të besimtarëve, sepse ata që bëjnë pallate apo shtëpi marrin urimet për qetësinë e disa trupave fizikë, ndërsa ata që ndërtojnë faltore, marrin urimin e mijëra

shpirttrave që do të shkojnë atje. Tri-katër vite më pas, dede Reshati, i rrethuar nga dashuria e çiltër e familjes Zaimaj, por edhe qindra besimtarëve përmetarë të ardhur në Bubs, në ceremonialin modest, do ta linte përgjysmë fjalën që kishte përgatitur dhe do të vijonte duke kënduar këngën e famshme të Abaz Aliut me vargjet e Naimit dhe vështrimin e tretur në Malin e Tomorrit.

Vallja e kënga ndalon sot vetëm në disa çaste. Dervish Admir Selmanaj përcjell urimet më të mira të Kryegjyshit Botëror Bektashian, Hirësisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, duke uruar fat e

mbarësi në çdo familje.

Ndërsa nuk mungon me urimin e saj edhe nënë Sanija e cila e mbyll përsëritetjen me fjalët: "Marshim nga drita e baba Aliut dhe dede Reshat Bardhit! Ky çirak në Bubs, mos u fiktë në shpirttrat tanë!

Kështu ju do nëna të gjithëve, të mbledhur së bashku dhe me këngë në buzë!" Zemrat e mbushura me besim, sigurisht janë më të lumtura. Vetëm ato dinë t'i marrin edhe përcjellin këta kode të dhimbshëm, duke i shndërruar në hapësira të pafundme shprese.

Syrja Xhelaj
Bubs, 15 gusht 2019



Gëzimi i kësaj dite

Në pranverën e sivjetme nga fshatrat e Kolonjës si: Butka, Bezhani, Mileci, Skorovoti, Kreshova, Starja, Rehova, Taçi, Prodani dhe Gjonçi, erdhën shumë besimtarë bektashianë për të ndarë së bashku gëzimin e festës. Gjithësesi nga Helmësi, Qafëzezi, Mollas, Shtikë, Qinam, Selenicë, qyteti i Ersekës, Borovë, Novoselë, Luraras, Boshanj dhe Qafzez si edhe nga Orgocka, Qinami, Radovicë; Kaltanj, Qesarakë, Selenicë e pishës, Qytezë, Shënmërtir, Gërmenj, Podë, Sanjollas, Kamnik, Leskovikë dhe Glinë ishin të pranishëm në pelegrinazhin e teqesë së Qesarakës. Shumë nga të rinjtë muarën revistën "Urtësia" dhe e kërkonin atë, në bisedë e sipër me ta më çuditë që kishin ardhur edhe nga fshatrat më të largët të Kolonjës dhe Leskovikut. Ata shpreheshin se baballarët na kanë folur shumë për teqenë e Qesarakës dhe një pjesë e tyre janë të moshuar nuk vijnë dot por na nxitin ne, dhe na thonë shkoni bij, se atje do merni uratën e mirësisë, të dashurisë, të vëllazërisë, se dervishët dhe baballarët e teqesë së Qesarakës e mbanin teqenë ditë dhe natë hapur, ajo gumëzhinte si një koshere bletësh nga Rilindja Kombëtare e deri sa u mbyll në vitin 1967. Prandaj vijmë me mall e me shpresë. I shikon pelegrinët të qeshur dhe të gëzuar me ndenjë të pashur dhe të zjarrtë erdhën për tu falur në tyrben madhështore të Haxhi Babait. I gëzohen kësaj dite të veçantë këtu në teqenë e Qesarakës na pret me respekt dhe gëzim tyrbetarja, znj. Naime Alia me vajzën e saj qerasin dhe u thonë mirëseardhjen pelegrinëve të shumtë. Po kështu Ajet Islami dhe Ëngjëll Dervishi të gjyshitës Korçës përshëndesin dhe meren me organizimim që të dali sa më mirë kjo ditë. Rreth teqesë dhe tyrbes të shumtë janë të rinjë dhe fëmijë e besimtar të vjetër të cilët me gëzimin e tyre respektojnë dhe meditojnë në mezarët e shënjtorëve. Therin kurbanët e caktuar për këtë ditë të shenjtë,

të rinjë në atmosferën e këngëve bektashiane i japin gjallëri pelegrinazhit rreth gjelbërimit pranveror. Tregtar të ndryshëm të ardhur nga Korça, Erseka plotësojnë kërkesat e pelegrinëve. Në një ceremoni të thjeshtë natyrshëm para teqesë marin pjesë përfaqësues të Bashkisë Ersekës, administrator të njërive administrative, kandidatët për Kryetar Bashkie z. Erion Isai, z. Fatjon Feka Nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane dervish Sali Peti me këtë rast, ai jep mesazhin e Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve. "Pjesëmarrja juaj në këtë pelegrinazh të veçantë në teqen e Qesarakës është mirësi, dashuri për të gjithë juve dhe familjeve tuaja. Teqeja e baba Brahos të Qesarakës, ka një histori të ndritur. Ajo ka qënë një strehë e besimtarëve të devotshëm në Zot, sikundër edhe strehë e luftëtarëve të lirisë së kombit. Ashtu si edhe teqetë e tjera të kësaj treve, si ato të Starjes, Kreshovës, Ersekës, Leskovikut, etj, ky kandil i Haxhi Bektash



Veliut, mbeti i pafikur në shpirtat e besimtarëve. Në vitet e vështira të ndalimit të fesë nga rregjimi komunist nga viti 1967 e deri 1990, besimtarët tuaj fshehurazi ndiqnin ritet tradicionale bektashiane, duke shpresuar se Zoti i Madhëruar nuk do të harronte sakrificat e tyre, ja sot të gjithë besojnë dhe janë të lirë të besojnë në një Zot. Teqeja e Qesarakës mbart në vete një histori të lavdishme. Kjo histori është e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me ndërgjegjen morale dhe kombëtare të popullit të Kolonjës, si edhe me aspiratat për liri dhe pavarësi. Emri i kësaj teqeje, lidhet padyshim me Haxhi Babanë, histori kjo kur Haxhi Babai kosankroi varrin kenotaf të Abaz Aliut në Tomorr, duke sjell dheun e 72 dëshmorëve të Qerbelasë, një kuran të shkruar me dorë dhe një shpatë druri, atje në Çukën e Tomorrit. Ashtu si në legjendat dritdhënëse, Haxhi Babai ndali diellin perëndues këtu në Qesarakë, e pastaj kaloi nga kjo jetë. Kur populli i fshatit dhe zonës, në shenjë përkujtimi për këtë shenjtor të madh ngriti tyrben madhështore. Kjo tyrbe jo vetëm që u bë simbol i dashurisë, mirësisë, vëllazërisë por gjithë dervishët dhe baballarët mbajtën gjallë kandilin e pafikur të Haxhi Bektash Veliut por edhe virtytet më të lartë morale dhe hyjnore, në Rilindjen Kombëtare me moton e tyre "Pa atdhe nuk ka fe". Edhe në vitet kur u ndalua me ligj feja nga sheti monist pas 1967, besimtarët nuk e humbën shpresën në dashurinë ndaj Zotit. Falë proceseve demokratike pas vitit 1990, por me fymën tonë, të klerikëve bektashianë dhe me mbështetjen tuaj të pamohuar, hap pas hapi, kësaj teqeje

po i rikthehej lavdia e dikurshme. Nuk mund të harrohen klerikët udhëheqës shpirtëror të njëpasnjëshëm të cilët lanë gjurmë në historinë e teqesë së famshme të Qesarakës si: baba Jahjai, baba Selmani, baba Shukriu, baba Shabani, baba Ibrahim, i quajtur edhe baba Braho, që ishte në këtë post rreth fundit të shekullit 19 dhe fillimit të shekullit 20, i emëruar prej baba Abedinit të Frashërit, të tjerët që vazhduan pas tij deri në vitin 1967. Mbas vitit 1991 e drejtoi teqenë e Qesarakës, biri i urtë i dhëshmur i këtij vendi, kleriku baba Xhemal Shkëmbi. I ardhur prej fisit, i cili ka qëndruar përgjatë shekujve në ruajtje të traditave bektashiane, baba Xhemal Shkëmbin, e përkujtojmë sot me dashuri dhe respekt se ai e ringriti teqenë e Qesarakës, mbi themelet e vjetra, duke ruajtur vlerat më të mira bektashiane. Urime për festën që kini ardhur të festoni duke përtërirë dhe çuar më tej, mësimet bektashiane." Më pas përshëndeti nënkryetari i Bashkisë së Ersekës z. Gjergj Qirjazi, i cili vuri në dukje se pelegrinazhet e përvitshme këtu në teqenë e Qesarakës sjellin jo vetëm gëzim por është një përkujtim i punës së madhe në shekuj nga dervishët dhe baballarët e kësaj teqeje. Është detyrë e të gjithëve të mbajmë gjallë amanetin e tyre për fe dhe atdhetarizmin". Pastaj z. Erion Isai uroj shëndet dhe mbarësi për të gjithë pelegrinët në këtë festë dhe Zoti ju bekoftë." Vazhduan këngët dhe nefeset bektashiane në oshtimën e natyrës së mrekullueshme në Qesarakë. Gëzim dhe dashuri kishte në këtë ditë të shenjtë.

Koresp. "Urtësia"



NË GJURMË TË BABA KAMBERIT

Nga Nuri Çuni

Në udhëtimet për në tyrben e baba Kamberit në Drisht të Shkodrës në prill-maj të këtij viti gjithçka është e veçantë dhe mbreslënëse. Sepse kjo na dha mundësinë të njihemi nga afër për disa të dhëna mbi historikun e kësaj tyrbeje të vjetër jo vetëm në zonën e Shkodrës por edhe në gjithë vendin. Duke kaluar Urën e Mesit një befasi e mrekullueshme çelet: harqet e kësaj ure me punim guri, që tregon jo vetëm historinë e saj por një nyje

lidhëse e rëndësishme për Shkodrën e malësinë dhe atë ballkanike. Fshati Drisht i mbështetur në faqen e malit, duke u ngjitur mbi fshat rreth 2 km, ka përballë tyrben e baba Kamberit, shkodranët i thonë edhe bab Kamberi dhe në kodrën përball tyrbja e Gishtit. Është kënaqësi e veçantë të shijosh këtë mrekulli të natyrës dhe burimin jetdhënës, që buron pranë këtij vendi të shenjtë. Të bënë përshtypje se përball në horizont duket kalaja e Drishtit, dhe qyteti i dikurshëm me famë në mesjetë që u shkatërrua në pushtimin osman të shek XV-XVI. Historia flet për besimet fetare në Shkodër dhe

rrethinat e saj, duke përmendur kushtet historike të lindjes dhe zhvillimit të tyre. Sipas të dhënave burimore, ndërtimi i teqeve në Shkodër ka filluar me ardhjet osmane dhe morën zhvillim në mënyrë të veçantë në shekujt 16 dhe 17. Disa familje jeniçerësh ishin bektashinj, këta ndihmuan në përhapjen e bektashizmit në Shkodër dhe Drisht. Gjurmimet e bëra të studiuesve shkodran si: Islam Dizdari, Hamdi Bushati (në veprën e tij "Motet e Shkodrës") e të tjerë flasin se, në fillim të sundimit të Mustafa Pashë Shkodrës, numëroheshin 70 teqe të tarikateve të ndryshme. Por,



nga teqetë kryesore të bektashinjve njiheshin teqeja në Kullukhane, në pazarin e vjetër, teqeja nën kala, ku ndodhej tyrbja e Baba Mustafës, lagja Alibegaj, teqetë në Shabanej, Durgut, Kiras, në rrugën Milotej dhe rruga Bekteshaj dhe teqja e Kasëm Ali Sulltanit, e cila ka historinë e saj pranë Urës së Baçallëkut. Në këtë teqe kanë shërbyer në vitin 1931-1932, Hajdar Babaj së bashku me dervish Qazim Bakallin. Kronika e Hasan Koplikut tregon që bektashizmi ekzistonte para shekullit XVII. Gjithashtu thuhet se shumë familje më të njohura shkodrane kanë ndjekur bektashizmin. Të tilla janë: Çaushollajt, Gjylbegajt, Dervishejt, Kullollajt. Gjithashtu në një gur varri të shtëpisë së Jusuf Efedi Tabakut është një mbishkrim me emrin Mehmet baba i vitit 1779, apo tyrbja e baba Kamberit në Drisht. Të gjitha këto tregojnë për shtrirjen e bektashizmit në Shkodër. Por historia flet edhe për përndjekjen e bektashinjve nga Shkodra në periudhën e sundimit të Bushatllinjve. Baba Ali Turabiu në librin e tij të vitit 1929 për historinë e bektashizmit shkruan: "Në Shqipërinë e Veriut ishte bërë katastrof antibektashane fort e madhe... Teqeja e Shkodrës, edhe ato të Krujës ishin prishur krejt. Lagjia e bektashinjve në Shkodër, lagjia e Tabakëve që ishin bektashinj në Tiranë ishin prishur themelërisht..." Ngjarjet e vitit 1826, mbas dekretit të Sulltan Mahmudit të II me shkatërrimin e repartit të jeniçerve shkatëroi misonarët e tij në gjithë teqetë dhe i vrau dhe persekutoi bektashinjte kudo në botë si edhe në Shqipëri.

Kurse për tyrben e baba Kamberit në Drishtit ka këto të dhëna. Ky objekt kulti bektashian është themeluar në periudhën e ardhjes të osmanëve. Në fletoren epistolar të Shkodrës të vitit 1702, jepet një e dhënë për emërimin e një rojtari në tyrben e Kamber babajt në Drisht. Duke biseduar me disa besimtar si: Briken Nasufi, Neritani, Ilir Nurce por tyrbetari i familjes shumë shekullore 75 vjeçar, Qazim Tyrbetari

nga fshati Drisht mësojmë: "Gjysh stërgjyshit në breza na kanë lënë këto të dhëna, se baba Kamberi ka ardhur nga Horasni, u bë i njohur në gjithë zonën si misionar, por në luftimet e gjata turke në Drishtë. Ndodhi që baba Kamberi u plagos sa iu pre edhe gishti i dorës në kodër përball kalasë së Drishtit. Nga plagët e marra u ul në faqen e malit, por e mori etja për ujë, në këtë situatë me shpatën e tij çau malin dhe nxori ujë, bëri një mrekulli. Këtu mbas dy ditësh kaloi nga jeta, shokët e tij e varrosën afër çezmës që është edhe sot e kësaj dite. Tyrbetari vazhdon se nga familja e baba Kamberit ishin tre vëllezër, njëri quhej Shaban baba, i cili ka patur tyrbe por iu prish në vitin 1967 dhe Mujo Baba ka tyrben në Ulqin, në vendin e quajtur "Guri mbi gur". Baba Kamberit më vonë i ngritën tyrbe në këtë vend që është edhe sot, te burimi. Nga fisi im në breza dhe shekuj deri më sot që shërbejmë vendit të shenjtë ka shumë mrekulli. Tahir Ali Tyrbetari i parë i doli në ëndërr baba Kamberi dhe i kërkoi

në burgun e kalasë së Shkodrës. Gjatë natës Pashait i del në ender dikush që i tha: "Liro Sali Tyrbetarin!" Nga ky shkak dhe pothuajse gjithë natën ka mbetur pa gjumë. Pashai mësoi se kush ishte Saliu nga shokët e tij e liroi, por Saliu nuk pranoi pa liruar edhe nëntë shokët e tij. Pashai i liroi të gjithë. Qazimi shprehet se në fshatin tonë deri më sot kjo tyrbe frekuentohet nga të gjithë si nga myslimanët dhe të krishterët dhe ne gjithmonë të mira kemi patur nga vendi i mirë."

Për këtë tyrbe në Drisht flitet edhe në librin e tyre "Jeta dhe veprimtaria e Sheh Ahmed Shkodrës" nga autorët Faik Luli dhe Bujar Shehu. Sheh Ahmed Shkodra është një udhëheqës i shquar i tarikatit rufai i njohur në fushën e teologjisë, historisë dhe letërsisë shqipe. Në shënimet e tij ai shkruan:

*"Herët fort jam atdhetar,
Nuk e due kush asht tradhëtar,
Unë një herë kam ba be:
Për besim e për atdhe"*



ujë për avdes. Tahiri i çoi ibrikun me ujë te mezari në tyrben e tij, por kur erdhi të nesërmen nuk gjeti ujë në ibrik. Rasti tjetër Sali Barjam Tyrbetari ishte edhe "Myftar", kryeplak i fshatit, turqit e kapën me disa shokë të tij se nuk paguanin taksat dhe i burgosën

Ish Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, dede Ahmet Myftari me sheh Ahmed Shkodrën kanë patur një komunikim dhe bashkëpunim të veçantë midis tyre në vitet 1950-1958. Shumë autorë dhe studiues të tjerë kanë shkruar për sheh Ahmed Shkodrën, të dhënat e bijës së

tij, Fatime Reçi, qytetarët shkodran Ali Kraja e Hamza Cungu kujtojnë: "Ne na bënte shumë përshtypje veprimtaria e tij e gjithanshme fetare. Kujtojmë me emocione të veçanta vizitën e tij në tyrben e Drishtit. Ai hipur në kalë, me një flamur jeshil të qendisur me shkronja arabe dhe i shoqëruar nga dervishët, printe gjatë rrugës duke bërë ziqër e duke rënë tekbir".

Mbas vitit 1991, përr regullim e mirmbajtje të vendit të shenjtë u muar në fillim Dul Bakëri. Kurse në këtë periudhë Artur Hamzit iu shfaq në ëndër baba Kamberi. Ky i tha "Pse nuk po më rregullon tyrben?" Kështu at dhe bir Artur dhe Hysen Hamza, punuan me një përkushtim dhe dhanë një kontribut në rindërtimin e tyrbes së madhe të baba Kamberit në Drisht për këtë u jemi mirënjohës. Ata me përkushtimin dhe dashurinë ndaj Zotit, që në vitet e para të demokracisë për të mbajtur gjallë rrugën e Ehli-Bejtit bënë të mundur me ndihmën materiale, kontributin e tyre, të rindërtojnë këtë tyrbe madhështore të baba Kamberit, në përhapjen e frymës së vëllazërisë dhe shpresës për të gjithë banorët jo vetëm në Drisht por edhe në Shkodër e më gjërë. Ndërtimi pati shumë vështirësi se materiali u mbajt me karrocë dhe më krah. Sheshimin në brinjë e bënë me krah dhe rregulluan dhe burimin, muret rrethues. Për këtë u bë tyrbja me një dhomë shkallare dhe në fillim të majit bëjën festën e përvitshme. Ata shprehen: "Ne i lutemi Zotit dhe baba Kamberit që të duam njeri-tjetrin pa dallim bindje dhe besimi për të sotmen dhe të nesërmen". Këtu takojmë besimtarin e përkushtuar për teqen e Drishtit z. Briken Nasufi (Doxhi), vëllazëria e dervishve rufaj të Shkodrës banues në lagjen "Iliria", frekutojnë herë pas herë tyrben e baba Kamberit dhe adhurojnë atë në veçanti. Këtu ka ardhur dhe ish Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve dede Reshati, i cili është takuar me besimtarët e fshatit Drisht dhe të Shkodrës. Baba Selim Kaliçani, baba Mondit, sot Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, besimtarë nga Kruja vijnë gjithmonë gjatë vitit. Ky

vend i burkur dhe i shenjtë iu shtua edhe një bukuri tjetër, me porosi të Kryegjyshit Botëror Bektashian, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, ribërja e çezmës së baba Kamberit me këtë mbishkrim: "O njerëz të uruar Pini ujë të bekuar,

Nga baba Kamberi i shenjtëruar". Dita e pelegrinazhit e bëri të veçantë pjesmarrjen dhe nga gjyshata e Krujës mori pjesë sekretari Sadik Balla, dhe besimtarë rufaj, Ilir Nurce dhe të tjerë nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane me dervish Sali Petin, i cili bëri ritualin bektashian dhe dha mesazhin e Kryegjyshit Botëror: "Sot duke bërë këtë ceremoni ne kujtojmë dhe ruajmë gjallë, gjurmët në këtë vend të shenjtë ku pimë ujë



nga çezma e mrekullive që e ka lënë baba Kamberi. E këtij shenjtori të madh që dhuroi dashuri, ndaj Zotit ndaj Profetit Muhamed, ndaj 12 imamëve, e familjes së Ehli-Bejtit. Por edhe dashurinë për vatanin, për gjuhën dhe shkollën shqipe. Vepra e mirë fut dashurinë te çdo besimtar ndaj Zotit dhe punë të mira nga të gjithë. Në shumë hadithe ka dhe vlerësime për vepra të mira. Kjo rrjedh nga edukimi shpirtëror që bënë çdo besimtarë, klerikë në përsosjen e shpirtit të sejcilit. Dervishët dhe baballarët iu drejtohen besimtarëve në çdo kohë për të patur vlera si: diturinë, mirësinë, bamirësinë, sakrificën, drejtësinë, faljen, mbrojtjen e të paafteve dhe të pafajshmëve, besnikërinë dhe amanetin. Këto burojnë nga nevoja morale që shërbejnë për të arritur kulmin e pjekurisë shpirtërore. Imam Aliu ka thënë: "Çdo njeri që ka njohur vetveten, punët e tij janë të vlefshme."

Biseda e ngrohtë dhe foto rreth tyrbes dhe çezmës e bëri të gëzueshëm dhe me besim uruan njëri tjetrin për të brë më shumë punë në këtë tyrbe dhe tyrben e Gishtit në kodrën përball, rrugën nga fshati Drisht e deri te tyrbja. Besimtarit Neritan me shumë pasion më këndoï këngën e baba Kamberit, të cilën e këndojnë së bashku me shokët e tij në muhabete e sofa vëllazërie.

... Tu ba ziqër tu ba salavate.
O baba Kamberi jonë,
Ne ty do të kujtojmë,
Brez pas brezi s'do të harrojmë.

Ditët e vizitave në tyrben e Drishtit na sollën emocione por edhe detyrime për të nxjerrë më shumë të dhëna e pasurimin e historikut të kësaj tyrbeje të hershme në gjurmë baba Kamberit, këtij shenjtori që mbajti të pafikur edhe në kohërat më të vështira amanetin e dliër të Ehli-Bejtit.

Naim Frashëri i të gjithëve

Nga Tomorr Kotorri



Sot është një ditë e shënuar një ditë e veçantë është ditëlindja e poetit tonë kombëtar Naim Frashëri, pagëzuar si "Dita Naimjane". 25 Maji është kthyer tashmë në një traditë të bukur dhe kuptimplotë, këtu në Frashër të mblidhen nga tërë hapësirat mbarë shqiptare nga Kosova, Ulqini, Tetova, Tirana, Gjirokastra, nga Përmeti dhe Dangëllia. Të rinj gjimnazistë të ardhur nga Përmeti dhe Kosova, njerëz të letrave dhe kulturës, poetë të ardhur nga disa qytete të vendi tonë, përfaqësues të pushtetit vendor e qeverisë, përfaqësues shoqatash, personalitete e akademikë të shquar që me veprën e tyre i kanë bërë dhe i bëjnë shërbim të madh çështjes sonë kombëtare. Kjo pjesëmarrje kaq e larmishme në këtë ditë të shënuar, sepse Naimi na ka bashkuar dhe na bashkon, ai mbetet i të gjithëve. Naimi dhe vëllezërit, Samiu e Abdylit, mbeten simbole të dashurisë për Atdheun, të dashurisë për popullin dhe njeriun e thjeshtë. Kjo traditë vijon të mbetet e gjallë dhe frymëzuese dhe edukative për brezat e sotem. Naimi është mesuesi i popullit, atdhetar, poet i Rilindjes sonë Kombëtare, mendimtar, këngëtar i madh i lirisë së atdheut dhe i lirisë së njerut. Unë besoj e shpresoj se, kjo veprimtari kombëtare dhe 17 veprimtaritë që kemi organizuar këtu në Frashër duke filluar nga 18 qershori i vitit 2004 dhe deri më sot më 25 maj 2019 kanë shërbyer dhe i shërbejnë për

lartësimin e veprës madhore të vëllezërve Frashëri por edhe si një thirrje për të kthyer kokën nga Frashëri për ta kthyer në një qendër historike-turistike-muzeale. Për këtë shqetësim kemi përgatitur dhe një dokumentar Frashëri dje, sot, si mendohet që të jetë nesër përgatitur nga shoqata e Vëllezërve Frashëri dhe Medi Shaqiri si djali i Gastomickës dhe Frashërit. Mirëseardhjen e bëri kryetari i Shoqatës së Vëllezërve Frashëri: "Mirëseardhet në Frashërin tonë, në Frashërin e historisë dhe të kulturës, në vendlindjen e vëllezërve Frashëri: Abdyl, Naim, dhe Samiut. Mirëseardhet edhe në teqenë e baba Nasibut dhe baba Alushit, në këtë teqe atdhetare dhe historike, mirëseardhet në Mekën e Shqipërisë!... Si Sot më 25 maj të vitit 1846, 173 vite me parë në këtë shtëpi, të lashtë me tradita patriotike, atdhetare dhe kulturore nënë Emineja lindi fëmijën e vet të katërt, Naimin, i cili së bashku me vëllezërit e tij, do të merrte përsipër detyrën e madhe historike, ta bënte Shqipërinë, të bënte gjuhën shqipe, të ndriçonte mendjet e zemrat e shqiptarëve, drejt lirisë dhe përparimit. Kështu, vëllezërit Frashëri dhe kjo vatër ku lindën, është e do të jetë i vendi shenjtëruar i shqiptarëve.

Siç e shikoni "Ky Frashër i lavdishëm, ky vend i shenjtëruar nuk duhet lënë kështu." Do ta ruajmë

e t'i kthejmë nderin atdheut, historisë e vetvetes, apo do ta lëmë të humbasë e të mbetet vetëm në këngët e dhimbshme e në faqet e ftohta të historisë? Frashërin nuk e bën e nuk e mban dot as bashkia Përmet, as rrethi. Ai është i kombit e ashtu duhet të vlerësohet. Ai është unikal, e kërkon që shteti e shoqëria shqiptare ta shohë unikal, si një zë më vite në zhvillimin e përparimin e vendit... Janë hedhur idetë dhe është përpunuar programi i ruajtjes dhe zhvillimit të Frashërit: "Nëse Frashëri duhet të ketë jetë e nder, duhet të kthehet në një Qendër Historike, Turistike-Muzeale. Po harruam Frashërin do të harrojmë historinë, gjuhën kombin. Frashëri duhet të bëhet Meka e Shqipërisë. Kjo është edhe klithmë edhe thirrje për të bërë atë që duhet, sa nuk është vonë..."

Traditë me përmasa kombëtare. Duke filluar nga 18 qershori i vitit 2004, në Frashër ka filluar një traditë e bukur Festive. Në përvjetorin e ditëlindjes së Naimit, për të përkujtuar vëllezërit Frashëri: Abdylin, Naimin, dhe Samiun, mbledhen aty nga të gjitha trojet shqiptare, në një veprimtari me përmasa të gjera kombëtare. Kjo traditë e bukur filloi me iniciativën e z. Tomor Kotorri ish kryetar i komunës Frashër dhe që nga viti 2004 deri në vitin 2011 organizatore e këtij takimi kanë qenë Komuna Frashër, në bash-



këpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Qendrën Kulturore Përmet. Këtë vit, 25 maj 2019, shoqata "Atdhetare kulturore mbarëkombëtare Vëllezërit Frashëri" ka bashkëpunuar me Bashkinë Përmet dhe Kryegjyshaten Botërore Bektashiane. Deri më sot janë organizuar 17 veprimtari kombëtare për jetën dhe veprën e vëllezërve Frashëri dhe patriotëve të tjerë. Në këtë veprimtari merrnin pjesë, Kryegjyshi Botëror Haxhi Dede Edmond Brahimaj, të zgjedhurit vendorë të Bashkive Përmet e Këlcyrë dhe të qarkut Gjirokastrë, Prof. Kristo Mertiri, gazetari i talentuar Marin Mema, prof. Gaqo Apostoli dhe shumë personalitete të shkencës dhe kulturës. Bukurinë kësaj feste ia shtonin dhe zërat e gëzueshme grupi letrar i Gjakoves si dhe nxënësit e shkollave të mesme të Rahovecit e Gjiilanit dhe të shkollave të mesme Sami Frashëri të qytetit të Përmetit, nxënës nga shkollat e mesme Këlcyrë. Një përshëndetje të veçantë bëri dhe Kryegjyshi Botëror Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili tha: "Më lejoni, sot në këtë veprimtari të mrekullueshme. T'ju uroj mbarësi e shëndet në familjet tuaja. Është nder i veçantë për mua që tradicionalisht organizohet për vit veprimtari të poetit të madh Naim Frashëri në vendlindjen e tij dhe në Përmet, të vëllezërve Frashëri dhe në teqenë e famshme të baba Alushit. Frashëri është kryeqendra e diturisë si të thuash Meka e Shqipërisë, tre vëllezërit Frashëri farkëtuan zgjimin kombëtar. Shekujt nuk e zhbën historinë, por vetëdija kombëtare u shndërrua në vatër të dashurisë për Zotin dhe Shqipërinë. Në këtë përshëndetje bashkohem me studiuesit vendas dhe të huaj, që bektashizmi në këtë trevë, frymëzoi breza të tërë me frymën e Zotit. Vençanërisht në ngjarjet kulmore të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, dhomat e teqesë së Frashërit, u mbushën si asnjëherë tjetër, me zërat e burrave që bënë historinë e kombit.

Përshëndes organizatorët për veprimtaritë e organizuara në vite, zotin Tomor Kotorri që punon parreshtur në këtë traditë të fituar nga viti 2004 e deri më sot, për të mbajtur gjallë mësimet e mrekullueshme, që dha Frashëri dhe vëllezërit e mëdhenj, Abdyl, Samiu, Naimi. Dita e Naimit është bërë kumt jo vetëm në Shqipëri por traditë e vyer në Maqedoni, Kosovë dhe Francë. Ne si Kryegjyshatë Botërore Bektashiane për të katrën herë organizojmë veprimtarinë ndërkombëtare në ditëlindjen e Naim Frashërit "Kultura bektashiane" në Paris të Francës. Të bashkuar të çojmë më tej ëndrrën e vëllezërve Frashëri".

Shoqata Atdhetare Kulturore e Vëllezërve Frashëri akordoi disa tituj nderi dhe çertifikata mirënjohjeje për personalitete të ndryshme që kanë kontribuar për Frashërin dhe Vëllezërit Frashëri si: ish Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Haxhi Dede Reshat Bardhi, Prof Kristo Mertiri, gazetari atdhetar, Marin Mema dhe poetit Sami Velcani e të tjerë studiues dhe kontribues.

Ndërsa Pof. Gaqo Apostoli ndau disa tituj "Ambasadorë të Paqes". Nxënësit e shkollës së mesme Sami Frashëri Përmet dhe nxënësit e shkollave Rahovec e Gjiilan, sollën atmosferë nga poeteka e Naim Frashërit. Veprimtaria vijoi përpara busteve të vëllezërve Frashëri me konferencën shkencore me temë "Fan S. Noli erudit dhe inkona e kultures shqiptare". Vazhdoi konferenca me kumtesën e parë nga historiani, Kasriot Bezati me temë: "Frashëri dhe rilindasit e kombit Shqiptar". Ndërsa poeti Lumo Kolleshi mbajti kumtesën: "Fan .S. Noli përkthyes i talentuar dhe stilist më i mirë i poezisë shqiptare." Kjo veprimtari vijoi me "Poeteka Frashër" dhe montazhi muziko letrar nga nxënësit e shkollës së mesme Sami Frashëri Përmet dhe nxënësit e shkollave Rahovec e Gjiilan e drejtuar nga poeti, Lumo Kolleshi. Ku poetët Andrea Petromilo, Riza Çato, Nikolla Spathari, Vladimir Muça, Pozaet Qose, Valter Dauti, Kujtim Stana, Lola Shehi, Ruzhdi Begaj, Sinan Elmazaj, Dhimitër Nica, Hysen Berisha, Xhelal Tosku, Sami Velçani, Anila Mihai si dhe dy Frashëllinj, Dhimitër Xhoga, Romo Gegushi recituan pjesë nga krijimtaria e tyre përballë busteve Naim Frashërit në këtë ditë të veçantë feste.

Te gjithë bashke vizituan shtëpinë muze të vëllezërve Frashëri. Ku sipas traditës u qirasën me raki rushi dhe me liko arre te oda e shtëpisë së vëllezërve Frashëri u prezantua dokumentari: "Frashëri dje sot dhe si mendohet të bëhet nesër" ku ish diplomati Medi Shaqiri bëri një përshkrim të shkurtër me foto dhe pamje nga Frashëri dje dhe një projekt si mendohet që të bëhet nesër. Këtë veprimtari kombëtare dhe konferencë shkencore ose "Dita Naimine", e kanë mbështetur, nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane, Bashkia Përmet si dhe biznesmenë përmetarë si z. Hysen Pasho, Shkëlqim Bejko, z. Llukan Kote. Me një piksynim të qartë, përkujtimi i krijimtarisë së Naimit të përjetohet në breza në vendlindjen e poetit e atdhetarit mëndjendritur këtu në Frashër. Më pas u vizitua teqja bektashiane në Frashër me pas u shtrua një drekë për të ftuarit te bar restorant Nemerçka afër qytetit të Përmetit.

ISLAM, LIKE A PEACE...

From the speech of the Bektashi World Leader, His Grace Hajj Dede Edmond Brahimaj in Berlin



Bismilahi Rrahmani Rrahim!
 In the name of God, the Most Beneficent, the Most Merciful.
 Dear brothers and sisters, high representatives of the religions, present here today!
 Honorable organizers of peace conference in Berlin!
 When we speak of violent extremism and terrorism, we are all sensitive, because in every religion and faith, since the early written in Pergamum tradition until today, our Lord has called only peace and goodness. It is an undeniable fact that from the generations of

more than a billion current Muslims, the saying "Selam alejkum" is whispered, meaning peace in both worlds, in this temporal and the other, eternal. This peace miraculously, one billion or more Muslims do not wish only to family and relatives, but to the whole world in every country where they live.
 The essence of Islamic philosophy is peace, it is the submission to the divine will of the Creator, is the order to the end of physical life to put His words in place. Muslims are the emblem of goodness, so in Qur'an Kerim is literally said: "...

anyone who kills someone who has not killed anyone or has not caused any disorder in this world is like he had killed all the humanity. And if someone save a life, it's like saving the lives of all people ...
 "Such a synthesis of the relationship between people and human society itself with the Creator is almost unique in all of our sacred books.
 However, in most cases, especially in the last two or three decades, international terrorism is attached to the term "Islamic" and coupled with media noise, it creates the feeling that this threat of world peace comes only from Muslims. It's strangely strange, but newspaper sites, especially in Europe, as well as the most watched television shows, undertake to "undo" the Muslim doctrine, without realizing that it is in essence universal divine mercy. It is also strange that such events as the massacres of Serbs in Bosnia against innocent Muslims or those of Moscow against Chechen Muslims, children in Palestine, genocide against Kosovo, Albanians and other painful realities are left on the periphery of human memory.
 In this context, I would remind you today that terrorism has no religion, homeland, color or ethnicity. Organized or not, coming from Muslims, Christians or Bud-

dhists, terrorism involves a range of human, dictatorial, economic, and cultural phenomena, first of all to be recognized from their birth and then analyzed in the light of developments today.

Not necessarily the frightening term "fundamentalism" relates to today's Islam, on the contrary, this effort should be seen as coming from those who do not really know the essence of Islam. A more in-depth analysis of human society structures, studies of moral-cultural formations as well as Muslim religious traditions can help us to perceive realistically the dangers of terrorism today.

Dear Present!

The nation to which I belong ethnically, Albania has been and remains sensible to any kind of violent extremism or terrorist act. We have inherited from our spiritual ancestors a wonderful religious coexistence and we continue today to model the future through what Pope Francis underlined in his visit to Albania as "religious brotherhood". This current religious status has not made us indifferent to the developments and tendencies of faith, rather, we are consciously aligned alongside the truly progressive forces for building bridges of religious peace and the denunciation of any vandalism allegedly coming from different sides.

Allow me to let you know about a Qur'anic hadeeth that say exactly: "Everything good that comes to you, man, comes from the Supreme Lord. Every evil that strikes you is from your own self!" (An-Nisa 79).

Therefore, let us unite together against evil. For today's and tomorrow's generations. For universal peace.

May God bless you all!
 Amen!



Not necessarily the frightening term "fundamentalism" relates to today's Islam, on the contrary, this effort should be seen as coming from those who do not really know the essence of Islam. A more in-depth analysis of human society structures, studies of moral-cultural formations as well as Muslim religious traditions can help us to perceive realistically the dangers of terrorism today.



URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE

BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE

NR.132 QERSHOR 2019

